

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

**FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И КОМУНИКАЦИЈА
FACULTY OF LANGUAGES, CULTURES AND COMMUNICATION**

PROGRAMI: GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

STUDIMET E MAGJISTRATURËS

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

TEZA:

GJUHA E ZEJTARËVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

KANDIDATJA:

LAURETA SHEHU HAMZA

MENTORI:

PROF. DR. ZEQIR KADRIU

TETOVË, 2020

1 PËRMBAJTJA

Falënderime..... 2

Abstrakt.....	3
Abstract.....	4
анстракт.....	5
1. KAPITULLI I	7
1.1. HYRJE	7
2. KAPITULLI II	9
2.1. QËLLIMI I HULUMTIMIT	9
2.2. HIPOTEZAT.....	9
2.3. METODOLOGJIA E KËRKIMIT	10
2.4. METODAT E PËRDORURA NË HULUMTIM	11
3. KAPITULLI III.....	13
3.1.1. ÇKA ËSHTË ZEJTARIA	13
3.1.2. VËSHTRIM HISTORIK.....	14
3.1.3. KUPTIMI MBI ZEJTARINË	16
3.1.4. KOMUNA E RAHOVECIT	17
3.1.5. ZEJTARËT E KOMUNËS SË RAHOVECIT	19
3.1.5.11. VERËTARIA	55
4. KAPITULLI II	56
4.1. GJUHA SHQIPE	56
4.2. GJUHA LETRARE SHQIPE DHE GJUHA POPULLORE	58
4.4. GJUHA E ZEJTARËVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	61
5. KAPITULLI IV	62
5.1. ANALIZA E TË DHËNAVE	62
5.1.1. REZULTATET NGA ANKETAT.....	63
5.1.2. PËRFUNDIMET NGA ANKETAT	70
6. KAPITULLI V.....	73
6.1. PËRFUNIMET DHE REKOMANDIMET.....	73
6.2. Referencat	75
Vërtetoj se unë, Laureta Shehu Hamza, jam autorja origjinale e këtij punimi.	78

FALËNDERIME

U jam mirënjohës anëtarëve të komisionit të kësaj teme. Dëshiroj të falënderoj në radhë të parë mentorin tim, Prof. Dr. Zeqir Kadriun dhe anëtarët e komisionit Asst. Prof. Dr. Luljeta Adili Çeliku, kryetare dhe Prof. Dr. Vebi Bexheti, anëtar, në ndihmesën e dhënë në punimin e kësaj teme.

E gjithë kjo punë nuk do të arrihej pa një përkrahje nga familja ime. Ka mbisunduar një përkrahje morale dhe mirëkuptim nga ana bashkëshortit tim, Berkanit, ndërsa këtë punim ia dedikoj vajzës sonë, Melikës.

ABSTRAKT

Gjuha e zejtarëve të ndryshëm është një gjuhë mjaft komplekse, sepse përbën një pjesë shumë të rëndësishme të përditshmërisë shoqërore, por edhe profesionale. Njerëzit shërbehen

me punë të ndryshme nga zejtarë të ndryshëm në përditshmërinë e tyre jetësore. Për zejtarët, gjuha e tyre ka një rëndësi të veçantë, sepse me këtë, ata e kryejnë komunikimin e tyre kryesor profesional në mes veti, dhe në këtë mënyrë i japin një dimension të rëndësishëm përditshmërisë gjuhësore, e cila shpeshherë di të jetë e ndryshme me fjalët që përdoren në gjuhën letrare shqipe, që ndryshe quhet zhargon profesional.

Pikërisht tema e tezës sime është një analizë multidisiplinare e gjuhës së zejtarëve në komunën e Rahovecit, duke bërë një dallim të fjalëve që ata i përdorin në përditshmërinë e tyre, dhe një krahasim të fjalëve me gjuhën e sotme letrare shqipe. Ky dallim përfshin edhe pjesën e etimologjisë së këtyre fjalëve të zejtarëve pasi që në botën bashkëkohore kemi edhe zeje të reja dhe fjalët e tyre zakonisht janë marrë nga vendet dhe në gjuhën që fillimisht u zhvillua ajo. Kjo nënkupton se në këtë punim janë transkriptuar fjalët e përdorura në gjuhën e përditshme zejtare dhe në gjuhën letrare shqipe.

Në pjesën teorike të punimit, është bërë një pasqyrim i qartë të dallimeve esenciale ndërmjet gjuhës letrare dhe gjuhës së përditshme të zejtarëve të komunës së Rahovecit, dhe këto dallime a ndikojnë në deformimin apo pasurimin e gjuhës së sotme shqipe. Kjo ka një rëndësi të veçantë sepse jeta shoqërore është shumë më e zhvilluar se të gjitha dimensionet tjera si shkencore apo gjuhësore. Pikërisht zhvillimi i përditshmërisë shoqërore i detyron gjuhëtarët që në qarqet akademike t'i përgjigjen apo të vendosin se si të quhet dhe përdoret një term në gjuhën shqipe. Në pjesën praktike, qëllimi kryesor i imi ka qenë të jap kontributin tim në aspektin e zhvillimit të mirëfilltë të gjuhës në këtë kategori të shoqërisë dhe të hapet rrugë më e madhe për përdorimin e nocioneve të standardit të shqipes dhe më pak të fjalëve të huazuara.

ABSTRACT

The craftsmen's language is quite complex because it represents an important part of the everyday life and the professional life of a society. People use the services of many different

craftsmen, for different purposes, in their everyday life. To the craftsmen their language is vitally important because it helps them to fulfil their professional communication between them, and while doing so they give an important dimension to everyday language, which, very often, can be quite different from the standard Albanian language. The everyday language used by the craftsmen is also known as a professional jargon. Specifically, this thesis is a multidisciplinary analysis of the craftsmen's language in the municipality of Rahovec and a comparison of the words that these craftsmen use in their everyday life with the words of the today standard Albanian language. In the contemporary world there are new crafts, and if that is the case their words were taken from the language and the places they were developed initially, bearing this in mind this paper includes the etymology of the craftsmen's words, as well. This paper provides a transcription of the everyday language used by the craftsmen and the standard language. The theoretical part of the study contrasts the essential differences between the standard language and the everyday language of the craftsmen of the municipality of Rahovec, it also gives answers if these differences deform or enrich today Albanian language. This is crucial because societal life is much more developed than all the other dimensions of life, such as scientific or linguistic ones. It is exactly the development of the societal everyday life that makes the linguists to answer or decide how to call or use a term in Albanian language. As far as the practical part of the study is concerned, my main intention was to contribute in the development of the language of this societal category, reduce the usage of borrowings and increase the usage of standard Albanian language.

АПСТРАКТ

1. KAPITULLI I

1.1. HYRJJE

Gjuha, padyshim se është mjeti më themelor dhe më funksional i komunikimit ndër njerëzor në të gjitha sferat e jetës. Pa gjuhë në kuptimin e komunikimit, nuk ka edhe jetë për njerëzimin. Të menduarit dhe të folurit, na bën të dallohemi nga të gjitha qeniet tjera në botën që na rrethon. Ky është procesi më i rëndësishëm i cili na përcjell në të gjitha fazat e jetës, mjet të cilin e mësojmë në fëmijërinë tonë të hershme, dhe është mjet me të cilin shërbehemi deri në çastet e fundit të jetës sonë. Me procesin e të menduarit, ne jemi në një komunikim të heshtur brenda vetës tonë, komunikim i cili pa gjuhë, qoftë në të shkruar apo edhe në të folur, mbetet i mbyllur në brendësi të mendjes sonë, ndërsa me anë të gjuhës, qoftë në të folur apo në të shkruar, mendimin tonë të brendshëm e plasojmë jashtë në komunikimin tonë të përditshëm me subjekte të tjera. Edhe mendimi i brendshëm i mendjes sonë bazohet në një gjuhë të caktuar, sepse mendimi pa gjuhë është mendim kaotik. Pa emërtimin e subjekteve, të sendeve dhe të proceseve në botën që na rrethon, nuk kemi mundësi të artikulojmë mendime. Ndërsa emërtimi na ka shërbyer në konsolidimin e gjuhës. Padyshim se ky ishte një proces evolutiv dhe i ngadalshëm, dhe me zhvillimet shoqërore, jetësore, ekonomike dhe teknologjike, zhvillohet edhe gjuha.

Pasi që shihet qartë se gjuha luan një rol të rëndësishëm në botën që na rrethon, mund të arrijmë në përfundim se për sfera të ndryshme të jetës, gjuha ka përdorim të ndryshëm, në komunikim të përditshëm si gjuhë popullore, në komunikim shkencor e letrar, si gjuhë letrare, apo edhe në komunikim të punës apo të profesionit si gjuhë profesionale.

Në komunikim të përditshëm, apo më mirë të themi në komunikimin e zakonshëm, të cilin e përdorim në përditshmërinë tonë, gjuhën e përdorim si gjuhë popullore, e cila brenda

rrethit të caktuar, ka një përdorim të tillë, i cili na bënë të shërbehemi për përditshmërinë tonë brenda komunitetit, me të cilën shërbehemi për zakonshmërinë tonë të përditshme që nga fillimi i ditës dhe deri në fund të saj. Ky lloj i komunikimit përfshin komunikimin brenda familjes, shoqërisë, në rrugë, në treg etj. Ndërsa gjuha shkencore apo letrare, për dallim nga gjuha e zakonshme, është një gjuhë më formale, e cila e tejkalon dialektin, dhe shërbehet me rregullat strikte gramatikore, dhe si e tillë është e unisuar, dhe përdoret në qarqet intelektuale dhe institucionale, ku komunikimi është më formal. Prandaj, në shkrimet intelektuale nga cilado fushë shkencore apo letrare, por edhe në ato institucionale, përdoret gjuha e unisuar, me rregullat gramatikore, ku përveç përmbajtjes së shkrimit të tillë, rëndësi ka edhe forma e saj. Ndryshe nga gjuha e zakonshme apo e përditshme, dhe gjuha shkencore apo letrare, si lloj i tretë i komunikimit na paraqitet edhe gjuha profesionale. Ky lloj i komunikimit gjuhësor është më i ngushtë, sepse përfshin një grup të njerëzve të cilët kuptohen në gjuhën e tillë. Këta janë njerëzit e profesionit të njëjtë, dhe brenda profesionit që ushtrojnë, për sende apo procese të ndryshme që ndodhin në profesionin e tillë, kanë edhe emërtime të ndryshme brenda profesionit. Këto mund të jenë profesione të konsoliduara mirë, të cilat formësohen në kuadër të shkencës, dhe të tilla mund të jenë komunikimet e inxhinierëve brenda një fushe të inxhinierisë, komunikimet shkencore në mjekësi, komunikimi në gjuhën juridike nga ana e juristëve etj., dhe profesionet zejtare të cilat për dallim nga komunikimi i profesioneve shkencore, formësohen gjatë përdorimit të zejës së tillë, gjuhë e cila më tepër është konsoliduar si rezultat i zhvillimit të zejës në ushtrimin e zakonshëm të profesionit të tillë.

2. KAPITULLI II

2.1. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij punimi është që ta bëjë analizën e gjuhës së zejtarëve në komunën e Rahovecit sipas parametrave të ndryshëm duke përfshirë atë historik dhe gjuhësor. Në pjesën teorike të punimit, qëllimi im kryesor është të bëj një pasqyrim të qartë të dallimeve esenciale ndërmjet gjuhës letrare dhe gjuhës së përditshme të zejtarëve të komunës së Rahovecit, dhe këto dallime a ndikojnë në deformimin apo pasurimin e gjuhës së sotme shqipe. Kjo ka një rëndësi të veçantë sepse jeta shoqërore është shumë më e zhvilluar se të gjitha dimensionet tjera si shkencore apo gjuhësore. Pikërisht zhvillimi i përditshmërisë shoqërore i detyron gjuhëtarët që në qarqet akademike t'i përgjigjen apo të vendosin se si të quhet dhe përdoret një term në gjuhën tonë të bukur shqipe. Në pjesën praktike, qëllimi kryesor është që të jap kontributin tim në aspektin e zhvillimit të mirëfilltë të gjuhës në këtë kategori të shoqërisë.

2.2. HIPOTEZAT

Ky punim, që në fillim k hipotezat e saja. Ato ishin se në bazë të të dhënave me metodat e cekura, do të arrihet tek rezultati i caktuar me fjalët e caktuara të gjuhës së zejtarëve. Siç do të shohim tek analiza e të dhënave, tek disa profesione zejtare kemi një dallim shumë të madh të fjalëve që përdoren në gjuhën letrare dhe atë të zhargonit, ndërsa tek të tjerat ky dallim nuk është edhe aq i shprehur. Te përfundimet do të japim edhe arsyet e sakta të kësaj dukurie.

Hipotezat e këtij punimi janë:

- Hipoteza e përgjithshme dhe
- Hipoteza e veçantë.

Hipoteza e përgjithshme

- Gjuha e zejtarëve të komunës së Rahovecit është një gjuhë specifike, sepse përmban fjalë të cilat nuk mund të gjenden në gjuhën e përdorur në jetën e përditshme jashtë profesionit.

Hipotezat e veçanta

- Gjuha e zejtarëve është gjuhë profesionale;
- Çdo zeje i ka specifikat e veta gjuhësore;
- Gjuha e zejtarëve është e ndikuar nga vendet e ndryshme ku ajo i ka fillet e saja;
- Dita ditës fjalë të tilla gjejnë përdorim në komunikimin e përditshëm të shoqërisë.

2.3. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Secila punë shkencore duhet t'i shërbejë jetës në përgjithësi por edhe shkencës dhe profesionit të caktuar në veçanti. Nëse njohuritë e përgjithshme dhe faktet shkencore janë të themi trupi i një pune shkencore, metodologjia apo të themi më qartë, metodat e përdorura i japin shpirt një pune të caktuar.

Metodologjia e kërkimit dhe hulumtimit shkencor ka një rëndësi të madhe, sepse siç shkruajnë autorët Zakiq dhe Zindović, “ajo shqyrton rrugët e dijes, në veçanti njohuritë e përgjithshme teorike, metodat, procedurat, teknikat dhe instrumentet nga të cilat fillon, përkatësisht të cilat përdoren në themelimin e teorive shkencore në lëmine e caktuar. (Zakić & Zindović, 2010, f. 14). Siç shihet, ky është një definicion gjithëpërfshirës rreth metodologjisë, sepse i përmbledh të gjitha njohuritë e arritura deri më sot në degën e caktuar të shkencës, metodat më të mira dhe më të lehta për të arritur deri te e vërteta, procedurat, teknikat dhe instrumentet duhet të jenë në shërbim vetëm dhe vetëm të themelohen teoritë e reja shkencore në shkencën e caktuar, e në rastin tonë në gjuhësi.

Por çka në të vërtetë nënkuptojmë me fjalën metodë?

Çdo shkencë ka objektin e vet të studimit. Por, për t'u arritur qëllimi i caktuar, secila shkencë përdor metodat e caktuara, të cilat paraqesin veprimet subjektive të hulumtuesit lidhur me objektin e caktuar. Kështu, metoda është e lidhur ngushtë me objektin e studimit dhe njëra me tjetrën ndihmohen, sa që metoda duket vetëm si shprehje e lëndës në vetëdijen e atij i cili e zbaton atë (Ismaili O. , 2004, f. 14).

Termi **metodologji** gjenezën e ka nga greqishtja, ku fjala **methodos**, do të thotë mendim qasje përpunim apo rrugë për të arritur te e vërteta dhe fjala tjetër **logos** që do të thotë fjalë, shqyrtim apo shkencë. Pra, metodologjia është rrugë shkencore për të arritur deri tek kërkimet shkencore (Jakupi, 2005, f. 16). Edhe ky punim i ka përdorur metodat shkencore për t'i pasqyruar të arriturat shkencore por edhe për të arritur deri te e vërteta e fakteve.

Më poshtë do të flasim për metodat e përdorura në këtë punim.

2.4. METODAT E PËRDORURA NË HULUMTIM

Siç edhe thamë, metodologjia e përdorur ka një rëndësi të madhe për punimin shkencor. Për ta pasqyruar sa më mirë realitetin në terren me të arriturat shkencore, në këtë punim janë përdorur këto metoda:

- Metoda teorike;
- Metoda e intervistës;
- Metoda përshkruese;
- Metoda krahasuese (komparative);
- Metoda analitike.

Nuk do të mund të realizohej punimi duke përdorur vetëm njërën apo disa metoda, por të gjitha metodat e përshkruara më lartë kanë dhënë frytet e caktuara në rezultatin e kërkuar.

Me anë të metodës teorike janë shqyrtuar të arriturat shkencore dhe teorike për nevojat e këtij punimi, duke filluar që nga literatura, por edhe njohuritë e nevojshme. Detyrë themelore e kësaj metode ka qenë siç thotë autori Jakupi “për të përçuar, mbartur kritikën logjike epistemologjike në veprën shkencore, mbi të gjitha elementet teorike dhe teknike (Jakupi, 2005, f. 23).

Metoda e intervistës ka qenë njëra ndër pjesë qenësore, sepse me këtë metodë jemi ballafaquar drejtpërdrejtë me të dhënat nga terreni apo thënë ndryshe nga dora e parë e të dhënave. Intervistomi është realizuar në mënyrë të drejtpërdrejt me zejtarët e zejeve përkatëse, të cilët janë pyetur për pjesët dhe mjetet e caktuara, ndërsa ata kanë dhënë përgjigje për emërtimin e tyre brenda zhargonit por edhe për funksionin e tyre praktik.

Metoda përshkruese në këtë punim ka qenë e lidhur ngushtë me metodën e intervistës, sepse rezultatet e intervistës janë përshkruar gjerësisht me kuptimet e tyre.

Metoda krahasuese është përdorur për të bërë një dallim të qartë në atë se sa dallon gjuha e zejtarëve në realitet nga fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Kjo metodë ka qenë një vazhdimësi e intervistës dhe përshkrimit.

Metoda analitike në këtë punim ka ndihmuar të bëhen analiza të qarta të dallimeve jo vetëm dialektore, por edhe të atyre që janë brenda zhargonit të gjuhës së zejtarëve të komunës së Rahovecit. Siç edhe shihet, të gjitha metodat i paraprijnë njëra tjetër, por në të njëjtën kohë edhe i qartësojnë njëra tjetër si një varg. Metoda analitike ka shërbyer për ti dalluar qartë rezultatet në përfundim të këtij punimi.

3. KAPITULLI III

3.1.1. ÇKA ËSHTE ZEJTARIA

Veprimtaritë ekonomike kanë një rëndësi të posaçme për jetën e njerëzve. Me anë të këtyre veprimtarive, njerëzit e sigurojnë ekzistencën e vetë. Këto veprimtari ndikojnë që njeriu historikisht të ndikoj në përsosjen e saj, sepse edhe jeta njerëzore ka një dinamikë të madhe, ndërsa njeriu gjithmonë mundohet të jetë në hap me kohën. Veprimtaritë ekonomike janë nga më të ndryshmet dhe varësisht nga faza e zhvillimit të njeriut, kanë ndryshuar edhe format e saj. Kështu, njëra ndër veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike për jetën e njerëzve është edhe zejtaria.

Por, çfarë në të vërtetë është zejtaria?

Para se të flasim gjerësisht për këtë temë, në këtë pjesë vetëm do ta përcaktojmë domethënien e kësaj veprimtarie ekonomike. Në shumicën e shteteve, kjo veprimtari është e rregulluar me ligj. Prandaj, edhe ligjet e shteteve të Ballkanit japin definicionin e veprimtarisë së zejtarisë.

Për ta kuptuar sa më mirë domethënien e kësaj veprimtarie, do t'i shohim ligjet e shteteve të rajonit se çfarë kuptimi japin ato për zejtarinë. Sipas Ligjit të Kosovës për Zejtari, “Zejtaria nënkupton veprimtarinë e pavarur ekonomike, e cila ushtrohet nga personat fizikë me punë dhe mjete personale me qëllim të realizimit të të ardhurave (fitimit) në prodhim, qarkullim dhe ofrim të shërbimeve në treg” (Ligji Nr.2004/44 për Zejtari, 2006). Pra, siç shohim, në Kosovë, zejtaria definohet si një veprimtari me të cilën njerëzit, me mjetet e tyre personale të punës dhe me punë realizojnë të hyra. Ndërsa në pjesën tjetër të këtij definicioni, ky ligj përcakton se kjo veprimtari mund të realizohet me prodhim, qarkullim dhe me veprimtari shërbyese.

Ndërsa, Ligji për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë, zejtarinë e përkufizon si “veprimtaria ekonomike, nëpërmjet së cilës prodhohen të mira dhe/ose realizohen shërbime zeytare përmes punës me dorë ose në seri dhe, në disa raste, duke përdorur aftësitë krijuese” (Ligji Nr. 70/2016 për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë, 2016). Këtu shohim se, në Shqipëri, kjo veprimtari definohej si veprimtari ekonomike, me anë të së cilës prodhimi ose shërbimi i punës me dorë apo në seri realizohet duke e përdorur edhe aftësinë krijuese. Pra, aftësia krijuese e bën zejtarinë të dallohet si veprimtari.

Sipas Ligjit për Zejtarinë në Maqedoninë e Veriut, “veprimtari zeytare është prodhim zeytar, shërbime zeytare dhe veprimtari e zeytarisë vendase dhe artistike” (ЗАКОН ЗА ЗАНАЕТЧИСТВО (Објавено во Сл. Весник на РМ, бр.215 од 07.12.2015 година), 2015). Ky Ligj zeytarinë e përkufizon si prodhim dhe shërbim, por edhe si veprimtari artistike.

Këtu shihet se në të gjitha ligjet e cekura, zeytaria definohej si veprimtari e pavarur ekonomike, qëllimi i së cilës është të prodhojë apo të kryejë shërbime të ndryshme, me qëllim të realizimit të të ardhurave. Zaten, realizimi i të ardhurave është qëllim i çdo veprimtarie ekonomike. Ky lloj i prodhimit apo i shërbimit kryhet duke përdorur aftësitë krijuese, kreativitetin në punë dhe zakonisht është punë që realizohet me dorë, ku si karakteristikë paraqitet tek bizneset e vogla apo të mesme.

3.1.2. VËSHTRIM HISTORIK

Për ta kuptuar sa më qartë gjuhën e zeytarëve, si një nënlloj i gjuhës profesionale, në aspektin historik duhet fillimisht ta kuptojmë edhe zhvillimin e gjuhës në përgjithësi. Sikurse njerëzimi, ashtu edhe gjuha ka një histori të saj, ndërsa mendimi se gjuha ka një histori nuk është e re. Autorët e studimeve sociolinguistike theksojnë se interesimi për historitë e gjuhëve daton qysh nga koha romake, por gjuhësia historike merrej me studimin e sistemit gjuhësor

në planin kombëtar, ndoshta edhe nacionalist, por jo në planin shoqëror, ndërsa në shekullin e XV dhe XVI janë botuar edhe traktate për origjinën e gjuhëve të ndryshme si të frëngjishtes, të italishtes, të spanjishtes etj. (Shkurtaç, Sociolinguistika, 2003, f. 10), (Ibrahimi, Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike, 2012, f. 11). Sot hulumtimet gjuhësore janë shumëdimensionale, dhe e kanë tejkaluar studimin gjuhësor vetëm në planin kombëtar, dhe në këtë, kanë ndikuar shumë faktorë, sepse kemi një zhvillim të gjithmbarshëm tekniko-teknologjik në përmasa globale, dhe për këtë arsye edhe komunikimi ndër njerëzor është shumë i madh.

Përveç gjuhës, dhe krahas me te, edhe zejtaria ka pësuar ndryshime të mëdha. Me zhvillimin njerëzor, është zhvilluar edhe zejtaria. Mënyra e kryerjes së punëve dhe koha e kryerjes së punëve janë lehtësuar shumë, dhe në këtë lehtësim kanë ndikuar shumë faktorë, ku më të rëndësishmit konsiderohen si zhvillimi i kapaciteteve intelektuale profesionale dhe perfeksionimi i mjeteve të punës. Prandaj, edhe përdorimi i këtyre mjeteve dhe emërtimi i tyre bëjnë pjesë në gjuhën e zejtarëve, dhe siç do të shohim, kemi shumë faktorë të cilët në mënyrë evolutive kanë ndikuar në zhvillimin e gjuhës së zejtarëve në përgjithësi. Sot, krahas industrisë, zejtaria është profesion mjaftë i përhapur dhe ndikon në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërive moderne, ndërsa gjuha e zejtarëve është një gjuhë profesionale me karakteristika të veçanta, ku në formimin e saj ndikojnë shumë faktorë të ndryshëm.

Historia e njerëzimit është mjaft e vjetër. Bashkë me të edhe nevojat e tyre janë mjaft të lashta. Në të gjitha fazat e organizimit shoqëror dhe ekonomik kanë qenë të njohura edhe zeje të ndryshme. Siç edhe kemi cekur, trojet ilire kanë qenë të banuara mjaft herët. Në fund të paleolitit dhe gjatë mezolitit banorët parahistorik shqiptar i zbutën kafshët dhe filluan mbjelljen e bimëve. Kështu edhe filluan t'i prodhojnë mjetet e para për punët e tyre (Frashëri, 2008, f. 4). Pra, për tu zhvilluar dhe veprimtaritë tjera, është shfaqur nevoja e prodhimit dhe mirëmbajtjes së prodhimeve të ndryshme, qoftë bujqësore, por edhe të tjera për mbijetesë.

Zejtaria njihet si njëra ndër veprimtaritë më të vjetra e cila është zhvilluar me përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe të blegtorisë (Dameska, 2010, f. 179). Mirëpo me zhvillimin e jetës shoqërore, por edhe të teknikës dhe teknologjisë, shfaqen edhe forma të reja të zanateve. Sot, edhe zejtarët e ndryshëm përdorin edhe teknika të ndryshme më të sofistikuara për ta ushtruar veprimtarinë e tyre.

3.1.3. KUPTIMI MBI ZEJTARINË

Siç thamë, veprimtaritë ekonomike kanë një rëndësi të posaçme për jetën e njerëzve. Veprimtaritë e tilla mund të jenë prodhuese dhe shërbyese. Veprimtaria prodhuese i paraprin të gjitha veprimtarive të tjera ekonomike. Sepse, pa prodhim nuk mund të kemi send të luajtshëm. Ndërsa, kur kemi sende të tilla të luajtshme fillimisht, ballafaqohemi me riparimin e tyre. Ky riparim është i nevojshëm për t'ia zgjatur jetën sendeve tona. Vet qëllimi i ligjeve për këtë lëmi tregon se cili është qëllimi edhe i kësaj veprimtarie. E sipas qëllimit e kemi edhe kuptimin. Sipas Ligjit për zejtari në Kosovë, “Duke pasur parasysh nevojat e vendosjes së një sistemi modern, me qëllim të mbrojtjes së zejtarisë si veprimtari e pavarur ekonomike dhe me qëllim të realizimit të fitimit në prodhim, qarkullim dhe shërbimeve në treg (Ligji Nr.2004/44 për Zejtari, 2006). Këtu shihet se edhe më parë ka ekzistuar një sistem i zejtarisë, por qëllimi është që të vendoset një sistem modern, por edhe të mbrohet zejtaria si veprimtari e pavarur ekonomike. Ligji i Republikës së Shqipërisë për zejtarinë, këtë profesion e quan edhe mjeshtri (Ligji Nr. 70/2016 për Zeytarinë në Republikën e Shqipërisë, 2016). Pra, këta janë njerëz që këtë veprimtari të përditshme e ushtrojnë si mjeshtri të tyre. Këtë mjeshtri, Ligji i Republikës së Maqedonisë së Veriut në disa raste e quan edhe si “prodhim zeytar” (ЗАКОН ЗА ЗАНАЕТЧИСТВО (Објавено во Сл. Весник на РМ, бр.215 од 07.12.2015 година), 2015). Pra ky lloj prodhimi është përpunimi apo prodhimi në sasi të vogla me porosi.

Nga kjo kuptojmë se veprimtaria zejtare është një veprimtari kryesisht individuale dhe jo serike, e cila në qendër të vëmendjes e ka zejtarin apo mjeshterin.

3.1.4. KOMUNA E RAHOVECIT

Trojet shqiptare shtrihen në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Këto toka janë të banuara shumë herët. Rreth çështjes së banimit të tokave shqiptare, ekzistojnë mendime të bazuara se ato kanë qenë të banuara shumë herët. Historianët mendojnë se gjurmët e para njerëzore në këto toka i hasim në lashtësi dhe atë rreth 30 mijë deri në 10 mijë vjet para erës sonë, apo ndryshe thënë në kohën e *paleolitit të vonshëm* (Frashëri, 2008, f. 3). E njëjta vlen edhe për Kosovën. Faktet historike tregojnë se Kosova është territor i banuar që nga parahistoria. Klima e volitshme, kushtet natyrore, por edhe pozita e mirë gjeografike, kanë mundësuar zhvillimin e jetës në Kosovë. Kështu, duke u bazuar në burimet e shkruara antike dhe materialit të ofruar arkeologjik, mund të konstatojmë se banorët e parë në territorin e Kosovës kanë qenë ilirët, rrjedhimisht edhe fisi ilir i dardanëve. Ata, territorin e tyre kompakt e krijuan gjatë epokës së hekurit, ndërsa këtë territor kompakt e quajtën Dardani (Shukriu, 2008, f. 5). Gjatë gjithë historisë, është ruajtur kjo vazhdimësi dhe popullsia shqiptare paraqitet trashëgimtare e ilirëve.

Edhe Rahoveci, si qytet që gjendet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës paraqet të njëjtën rrjedhë. Ai, bën pjesë në grupin e qyteteve të lashta të Kosovës. Territori i kësaj komune shtrihet në lindje të Rrafshit të Dukagjinit. Ky është një lokalitet kryesisht fushor, por një pjesë e saj përbëhet edhe nga malet, dhe ka një sipërfaqe prej 276 *km*². Gjatë regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës, i cili është kryer në mars të vitit 2011, komuna e Rahovecit kishte gjithsej 56,208 banorë, prej të cilëve 55,166 ishin shqiptar. Ajo ka gjithsej 36 vendbanime, dhe përbëhet prej zonës urbane të qytetit të Rahovecit dhe 35 fshatrave të saj

(Regjitrimi i Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, 2013). Sipas vlerësimit të kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2017, në komunën e Rahovecit jetojnë rreth 60 mijë banorë, ndërsa dendësia e popullsisë llogaritet të jetë rreth $277.4 \text{ banorë/km}^2$ (Kosovës, 2017, f. 8). Ajo kufizohet me Gjakovën, Prizrenin, Suharekën, Malishevën dhe Klinën.

Në përgjithësi, nëse dëshirojmë ta njohim shkallën e zhvillimit kulturor, ekonomik e shoqëror të një popullsie, këtë më së miri mund ta kuptojmë nëpërmjet vështrimit që i bëjmë vendbanimit si një hapësirë gjeografike. Kjo sepse një rol vendimtar në krijimin dhe zhvillimin e vendbanimeve, padyshim se luan edhe faktori fiziko-gjeografik, i cili përbëhet nga bota bimore, klima, përbërja e truallit tokësor, relievi, më pas edhe faktorët shoqëroro-historik dhe ekonomik. Këtë rol e gjejmë edhe te Rahoveci me rrethinë. Pikërisht, këta faktorë kanë ndikuar që treva e komunës së Rahovecit të banohet shumë herët, dhe atë që nga lashtësia. Në këtë pjesë të Kosovës, në kohën e ilirëve janë krijuar shumë vendbanime, por për shkak të rrethanave të ndryshme siç janë sëmundjet e ndryshme, shumë nga këto vendbanime shpesh janë lënë, ku janë krijuar dyndje të shumta, por janë krijuar vendbanime të tjera afër atyre. Vendbanimet në territorin e komunës së Rahovecit sipas fakteve datojnë që nga parahistoria, më saktësisht nga kohe e neolitit. Në këtë komunë hasen gërmadhat e kalave që nga koha ilire, ku vlen të ceket Kështjella e Zatriqit, Gexhës, Gurkuqit, Rahovecit etj (Osmani, 2003, fv. 11-17).

Gjatë historisë, Kosova me shekuj të tërë ka paraqitur një kolektivitet të mëvetësishëm politiko-juridik. Ajo shquhej për territorin e saj kompakt dhe me popullsinë shumicë etnike shqiptare, e cila, sipas burimeve historike, si njësi e veçantë administrative, u konstitua me emrin Vilajeti i Kosovës me rregullativën turke të vitit 1864. Ky ishte njëri nga katër vilajetet shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane, territori i së cilës përbënte 22.900 km^2 (Bajrami, 2002, f. 33). Edhe Rahoveci bënte pjesë në kuadër të vilajetit të Kosovës, deri në pushtimin

serb të Kosovës në vitin 1912, të cilët menjëherë bënë ndarjen e re administrative dhe territoriale në qarqe e rrethe ushtarake e civile. Gjatë kësaj kohe, territori i komunës së Rahovecit i takonte Rrethit të Anadrinit, në kuadër të Qarkut të Prizrenit. Ndërsa më 23 janar 1914, Rahoveci shpallet qytezë edhe zyrtarisht, ku kanë jetuar 4.529 banorë, ndërsa në vendbanime kanë jetuar 34.000 banorë (Osmani, 2003, f. 38).

Komuna e Rahovecit ka një histori të pasur në zhvillimin e biznesit dhe të tregtisë. Ka të regjistruara rreth 3200 biznese. Ajo ka një potencial të madh në prodhimin e verës dhe të tokës pjellore, e cila do ta zhvillojë këtë anë në të ardhmen. Zhvillimi i ekonomisë në komunën e Rahovecit është i orientuar në bujqësi, vreshtari dhe perim kulturë. Vlerësohet se afro 65% e popullatës e sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Kështu, mesatarja e të ardhurave për një fermer brenda vitit llogaritet të jetë rreth 2500 deri në 3000 €. Komuna e Rahovecit disponon rreth 50% të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese.

3.1.5. ZEJTARËT E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Komuna e Rahovecit edhe pse është komunë me tipare të zhvilluara në bujqësi, në rrethinën e qytetit e është e zhvilluar me kulturën e vreshtave, ndërsa në pjesën e fshatrave përgjatë Drinit të Bardhë është e zhvilluar perimekultura. Vreshtaria i ndihmoi zhvillimit të madh të industrisë së verërave, ku për këtë arsye shquhet me numër të madh të bodrumeve të verërave të përmasave evropiane.

Krahas bujqësisë dhe industrisë së verërave, në komunën e Rahovecit është zhvilluar edhe zejtaria. Ndonëse jo në përmasat e bujqësisë, zejtaria filloi të zhvillohet sidomos pas luftës së vitit 1999, ku vlen të përmendet zhvillimi i zejtarisë së automobilizmit dhe atë në pjesën mekanike, elektrike dhe të karrocerisë. Veprimtaritë tjera të zhvilluara në komunën e

Rahovecit janë xhamaprerësit, argjendarët, ujësjellësit, zejtarët e produkteve të verërave, dhe sidomos ata të moto kultivatorëve.

Zejtaria si veprimtari ekonomike, për zanatet që do të flasim në vijim, në përbërjen e saj gjeografike është më tepër e përhapur në zonën urbane në krahasim me atë rurale. Tek zejtaria e automjeteve tani kemi një dallim sepse kjo veprimtari kohëve të fundit ushtrohet si në zonat urbane po ashtu edhe në ato rurale. Veprimtaria është e njëjtë, gjuha e njëjtë, por edhe fillet e saja i kanë të njëjta apo më mirë të themi nga burimet e njëjta. Në bisedë e sipër me këta zejtarë, shohim se shumë prej tyre veprimtarinë e tyre kanë filluar ta ushtrojnë në qytetet e përfaqësuara që e kishin ushtruar këtë veprimtari shumë herët. P.sh. shumë nga ta, hapat e para të kësaj veprimtarie i kanë marrë në qytetet e lashta të Prizrenit apo të Gjakovës. Në veprimtaritë e reja, ka nga ta që këtë veprimtari kanë filluar ta ushtrojnë në botën perëndimore, në vendet ku kanë shkuar si refugjatë.

Sot, sidomos në qytetin e Rahovecit, kemi mjaftë veprimtari zejtare që ushtrohen si traditë familjare, kemi disa nga to që kanë pushuar ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre për shkak se zhvillimi tekniko-teknologjik ka ndikuar që ta humbin kuptimin e tyre të ekzistencës. Por ka edhe të atilla që janë burim i vet qytetit të Rahovecit në Kosovë. Kjo ka të bëjë me veprimtarinë e verërave, sepse në Rahovec kemi 25 bodrume të regjistruara të verërave duke filluar nga ata me kapacitete gjigande deri tek ata me kapacitete dhe madhësi të ndërmarrjeve me përmasa familjare. Ndryshe, Rahoveci në Kosovë njihet edhe si qytet i rrushit dhe verës.

Në këtë pjesë do të flasim për secilin lloj të zejtarisë në komunën e Rahovecit, ndërsa për fjalët e përdorura në etnolinguistikën e tyre do të flasim në pjesën e analizave të të dhënave.

3.1.5.1. AUTOMEKANIKËT

Në kohën bashkëkohore, me zhvillimin e madh të teknologjisë së automobilizmit, dhe me kalimin nga mjetet primitive të udhëtimit dhe të transportit të mallrave në mjetet moderne, sidomos me zhvillimin e veturave me motor me djegie të brendshme, ky lloj i zejes është bërë mjaft atraktiv në gjithë botën. Rol kyç në këtë proces kanë luajtur edhe zhvillimi masiv i teknologjisë së prodhimit të veturave, ku sot në botë, korporatat multinacionale të prodhimit të veturave, prodhojnë me miliona vetura brenda vitit. E gjithë kjo ka filluar me zbulimin e makinës së parë me avull nga Xhejms Vat në vitin 1769 dhe më pas me zbulimin e parë të motorit me djegie të brendshme nga inxhinieri belg Leonir në vitin 1860 (Srebrenov, Senesov, & Zashov, 2012, f. 2).

Plotësisht, motori me djegie të brendshme u konstruktua nga Vankel në vitin 1960 me piston rrotullues, që përdoret edhe sot (Srebrenov, Senesov, & Zashov, 2012, f. 3). Që nga ajo kohë e deri më sot, kjo teknologji ka arritur kulmin e saj të zhvillimit. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Prodhuesve të Veturave me Motorë OICA (International Organization of Motor Vehicle Manufacturers), në vitin 2016 në botë janë prodhuar mbi 94 milionë njësi të veturave, ndërsa në vitin 2017 janë prodhuar afër 97 milionë njësi të veturave (OICA, 2019, f. 1).

Siç do të shohim në vijim, për shitjen e veturave në botë për vitet 2016 dhe 2017 në bazë të prodhuesve e paraqesim me tabelën në vazhdim:

WORLD MOTOR VEHICLE PRODUCTION
OICA correspondents survey

WORLD RANKING OF MANUFACTURERS

Rang	GROUP	Year 2016	Year 2017
		SUM	SUM
	Total	94 020 883	96 922 080
1	TOYOTA	10 213 486	10 466 051
2	VOLKSWAGEN	10 126 281	10 382 334
3	HYUNDAI	7 889 538	7 215 391
4	G.M.	6 971 710	6 856 880
5	FORD	6 457 773	6 386 818
6	NISSAN	5 556 241	5 769 277
7	HONDA	4 999 266	5 236 842
8	FIAT	4 681 457	4 600 847
9	RENAULT	3 373 278	4 153 589
10	PSA	3 152 787	3 649 742
11	SUZUKI	2 945 295	3 302 336
12	SAIC	2 564 786	2 866 913
13	DAIMLER AG	2 526 450	2 549 142
14	B.M.W.	2 359 756	2 505 741
15	GEELY	1 266 456	1 950 382
16	CHANGAN	1 715 871	1 616 457
17	MAZDA	1 586 013	1 607 602
18	DONGFENG MOTOR	1 315 490	1 450 999
19	BAIC	1 343 682	1 254 483
20	MITSUBISHI	1 091 500	1 210 263
21	SUBARU	1 024 604	1 073 087
22	GREAT WALL	1 094 360	1 041 025
23	TATA	925 205	932 387
24	IRAN KHODRO	636 000	710 869
25	SAIPA	531 000	648 324
26	MAHINDRA	605 376	612 595
27	ISUZU	654 480	612 421
28	CHERY	631 454	605 331
29	FAW	557 174	592 688
30	GAC	384 937	513 870
31	ANHUI JAC AUTOMOTIVE	651 291	493 199
32	BYD	510 572	421 590
33	BRILLIANCE	464 210	362 166
34	HUNAN JIANGNAN	335 585	315 363
35	CHINA NATIONAL HEAVY DUTY TRUCK	199 941	296 594
36	CHONGQING LIFAN MOTOR CO.	278 389	214 145
37	SHANNXI	116 034	189 066
38	ASHOK LEYLAND	145 434	160 208
39	SOUTH EAST (FUJIAN)	114 515	159 473
40	PACCAR	139 605	153 405
41	CHANGFENG	88 888	135 682
42	RONGCHENG HUATAI	84 621	132 511
43	TESLA	83 922	101 027
44	HAIMA CARS	152 980	94 932
45	GAZ	87 207	88 902
46	CHENGDU DAYUN	59 298	79 737
47	NAVISTAR	48 447	68 258
48	ZHENGZHOU YUTONG	71 192	67 231
49	PROTON	73 400	67 170
50	LEYLAND TRUCKS	14 729	59 795

Tabela 1: Ranglista e shitjes së veturave në botë për vitet 2016 dhe 2017 sipas prodhuesve të tyre.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, industria e veturave është njëra nga industritë më të zhvilluara të botës moderne dhe kjo është edhe arsyeja e zhvillimit të kësaj zejtarie gjithashtu. Numri i madh i veturave ka bërë që ato të kenë nevojë për mirëmbajtje të rregullt brenda afateve dhe kilometrave të kaluara.

Në Kosovë dhe në gjithë rajonin e Ballkanit edhe pse nuk e kemi të zhvilluar fare industrinë e prodhimit të veturave por edhe të industrisë së rëndë, zejtaria e automobilizmit është mjaft e zhvilluar. Portali i njohur Kosovar “Telegrafi”, më 9 shkurt 2019 ka publikuar një artikull me titullin “*Në vitin 2018, kosovarët shpenzuan mbi 183 milionë € për blerje të veturave*” (Telegrafi, 09.02.2019). Sipas këtij artikulli, në vitin 2018 në Kosovë “janë importuar 20 mijë e 689 vetura. Prej tyre, 17 mijë e 340 janë vetura të përdorura, ndërsa 3

mijë e 349 vetura të reja”. Bazuar në numrin e banorëve, ky është një numër mjaft i madh i veturave të importuara brenda një viti, gjë që dallohet edhe në përditshmërinë tonë.

Ky lloj i zejes është mjaft i përhapur në Kosovë, por edhe në komunën e Rahovecit. Nëse flasim për gjuhën që e përdorin automekanikët gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, atëherë në pjesën e analizës së fjalëve të përdoruara do ta shohim se karakteristikë e fjalëve të përdorura është se ato bazohen në gjuhën sllave, gjermane dhe pjesërisht në gjuhë të tjera. Gjuha sllave në përdorimin e këtyre fjalëve ka ndikuar për shkak se në kohën ish sistemit jugosllav, punëtoritë e automekanikëve kanë qenë pjesë shtetërore që quheshin “Remont” dhe gjuha zyrtare e tyre ishte serbishtja, ndërsa automekanikët në Kosovë kryesisht në punëtoritë shtetërore kanë qenë serbë. Ata, gjatë përdorimit të fjalëve për veglat dhe pjesët e ndryshme janë drejtuar në gjuhën serbe. P.sh. Çekanit i kanë thënë “Çekiç”, mbajtësit i kanë thënë “dërzhaq” apo edhe nyjës i kanë thënë “zglllob”. Gjuha gjermane por edhe gjuhët tjera kanë ndikuar për shkak se prodhuesit e veturave janë nga Gjermania dhe vendet tjera të zhvilluara. Me prodhimin e veturave në këto vende, ka ndikuar që edhe fjalët e përdorura nga këto gjuhë të transmetohen në gjuhën shqipe apo edhe gjuhët tjera të botës. P.sh. Kapaku i cili e mbulon motorin e veturës në Kosovë botërisht njihet si “hauba” që burimin e ka në fjalën gjermane. Apo edhe pjesa e cila në brendësi është lëvizëse dhe ndihmon në shkyçjen e motorit nga automekanikët njihet si “flapë”.

MOTOR

Karter – Pjesa e poshtme e motorit së veturës e cila është e destinuar që ta mbaj vajin e motorit, ndryshe njihet edhe si korita.

Radilicë – Boshti bërrylorë i cili është i destinuar për t’i lëvizur pistonat e motorit. Shkop i shkurtër, i holluar në të dy majat, që përdoret për të tjerë dhe për të mbledhur fillin, duke rrotulluar me dorë; pjesë e makinës së tjerres, që shërben për të derdhur dhe për të mbledhur

fillin; sasia e fillit e mbledhur në një shkop të tillë. Me furkë e me bosht. Derdh boshtin. Mbledh në bosht. Ndërroj boshtet (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 167).

Pompa e vajit – Pjesë e motorit të veturës e destinuar për ta lyer tërë pjesën e brendshme të motorit me vaj. Makinë a pajisje e posaçme që shërben për të nxjerrë nga toka ujë ose naftë, për të ngritur ujin në një vend më të lartë etj.; tullumb uji, trumbë. Pompë elektrike. Pompë ujitëse. Pompë vaji (benzine, naftë). Nxjerr me pompë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1516).

Hillzne – Pjesë e brendshme e motorit të veturës, ku qëndron pistoni dhe formon shtypje për të punuar makina me djegie të brendshme, që njihet si cilindri.

Klip – Piston - Pjesë e një motori, e një pompe, e një kompresori etj. në trajtën e një shtage, të një disku ose të një kupe, që lëviz e puthitur brenda një cilindri. Piston automjeti (automobili). Pistona unazorë prej çeliku. Lëvizjet e pistonit. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1488).

Bollsne – Pjesë e rrumbullakët brenda pistonit, e cila e lidh pistonin me pjesën tjetër të boshtit bërrylorë, që njihet si aksëza e pistonit.

Karrika – Unazat e pistonit – pjesë unazore e cila qëndron në piston dhe ndalon humbjen e shtypjes së makinës me djegie të brendshme, ku njëkohësisht e ndalon edhe hyrjen e vajin në pjesën shkrepëse të makinës me djegie të brendshme. Rreth prej metali ose prej një lënde tjetër të fortë, që përdoret për të bashkuar a lidhur diçka, për të shtrënguar, për të mbajtur diçka etj.; hallkë. Unazë e jashtme (brendshme). Unazë shtrënguese (rregulluese, lidhëse). Unazë mbrojtëse. Unazë hekuri (bronzi, qelqi). Unaza e kosës (e këmborës). Unaza e qelësit (e parashutës). Unaza e thepit. Unazat e zingjirit. Unazat e perdeve. Unaza e hundës hundej. Në trajtë unaze. E shtrëngo me unazë. Futet në një unazë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2088).

Llagera leteqi – Kushinetë fluturuese – Pjesë e cila e lidh boshtin bërrylorë të makinës me djegie të brendshme dhe mbajtësit të pistonit Pjesë makine, e përbërë nga dy rrathë çeliku të petëzuar, të vendosur njëri brenda tjetrit me disa saçma të lëvizshme në mes tyre, që shërben për të lehtësuar rrotullimin e pjesëve të tjera të makinës. Kushinetë e vogël (e madhe). Prodhimi i kushinetave. Lyej kushinetën me vaj (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Llagera lezheqi – Kushinetë statike – Pjesë e cila e mban të stabilizuar rrotullimin e boshtit e gunga të makinës me djegie të brendshme.

Blok – tek. Tërësia e pjesëve të një mekanizmi ose të një pajisjeje, të lidhura së bashku për një punë. Blloku i cilindrave. Blloku i motorit. Blloku i zërit në televizor. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 158).

Kokë e motorit – Pjesa e epërme e motorit me djegie të brendshme.

Ventila isusni – Valvule thithëse e motorit me djegie të brendshme.

Ventila izduvni – Valvule dalëse apo shterës e motorit me djegie të brendshme.

Gvozhica – Pjesë cilindrike e ngjitur në kokën e motorit brenda së cilës kalon valvuli thithës dhe dalës, që ndryshe quhet edhe trangu i valvulës.

Gumica të ventilave – E mbrojnë depërtimin e vajit në pjesën ku shkaktohet shkrepja e djegies brenda motorit, ndryshe njihet si pyka gjysmë rrethore konike.

Diktun i kokës – Pjesë e cila krijon hermetikë ndërmjet bllokut të motorit dhe kokës cilindrike, ndërsa njihet si shtupuesi i kokës.

Diktun i karterit – Pjesë e cila krijon hermetikë ndërmjet bllokut të motorit dhe koritës së motorit.

Diktun i deklës – Pjesë e cila krijon hermetikë ndërmjet kokës së motorit dhe kapakut të kokës.

Deklla – Kapaku i cili e mbulon pjesën e epërme të kokës së motorit.

Isusna grana – Dega thithëse e cila e thith ajrin brenda në motor

Izduvna grana – Dega dalëse nga e cila del ajri i ngrohtë pas thithjes dhe përfundimit të procesit të djegies së brendshme nga motori.

Turbinë – Rrotë me bisht të fortë e me fletë rreth e rrotull, që vërtitet me anë të forcës së ujit, të avullit ose të gazit dhe që vë në lëvizje gjeneratorin. Turbinë elektrike. Turbinë ume ujë (me avull). Turbinat e hidrocentralit. Fletët e turbinës. Hidrocentral me katër turbina. Reparti i turbinave. U vu në prodhim turbina e dytë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2040)

Bosh pumpa – Furnizuesi i motorit me djegie të brendshme me lëndën djegëse.

Dizne – Injektorët - që me presion e injektojnë karburantin në hapësirën për djegie.

Komanda – Komandoj - tek. Vë në lëvizje; drejtoj. Anijen e komandonin nga toka. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 852).

Gumicat e dizneve – Pyka gjysmë rrethore të vendosura në injektor.

Hiberllaufen – Pjesë e motorit me djegie të brendshme për ajrosje të motorit.

Hlladnjak i interkullerit – Ftohës i ajrit i cili kalon nëpërmjet turbinës së motorit me djegie të brendshme.

Hlladnjak i klimës – Ftohës i amoniakut të klimës, i cili e mban shtypjen brenda klimës nën kontrolle.

Hlladnjak i ujit – Ftohës - Mekanizëm a pajisje që shërben për të ftohur mjedisin ose diçka tjetër; pjesë e një makine që shërben për ftohjen e diçkaje. Ftohës elektrik. Ftohësi i furrës. Ftohësi i pompës. Ftohësi i makinës me avull.

Hlladnjak i vajit – Ftohës i vajit të motorit me djegie të brendshme.

Egr ventil – Ventil i cili e djeg për herë të dytë ajrin e dalë nga motori me djegie të brendshme.

Fllapa – Pjesë e cila i ndihmon ndërprerjes së punës në mënyrë më të lehtë të motorit me djegie të brendshme.

Bojler i egr – Ngrohësi me ujë i pjesës e cila e djeg për herë të dytë ajrin e dalë nga motori me djegie të brendshme

Bregasta – Boshti bregorë (me gunga).

Hidraulikat e ventilave – Rregulluesi hidraulik i hapësirës (distancës) së valvolës - Që vihet në lëvizje me anë të trysnisë së lëngjeve; që nxirret a që bëhet me anë të trysnisë së ujit; që shfrytëzon energjinë e ujit. Makinë (presë) hidraulike. Motor (vinç) hidraulik. Tërheqje (goditje) hidraulike. Metoda hidraulike e nxjerrjes së torfës. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 676).

Auspuhu – Pjesa e fundit ku del ajri i motorit me djegie të brendshme.

Katalizatori – Pjesë e cila në një masë e ndalon daljen e dyoksidit të karbonit jashtë. kim. Lëndë që përdoret për të shpejtuar, për të ngadalësuar ose për të ndryshuar rrjedhën e një reaksioni kimik, por që vetë nuk pëson asnjë ndryshim. Përdorimi i katalizatorëve. Vetitë e katalizatorit. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 797).

Partikull filtri – Pjesë e cila në masë të madhe e ndalon daljen e dyoksidit të karbonit jashtë.

Sonda e partikullit – Pjesë e cila e mat sa është mbushur me dyoksid të karbonit partikull filtri

MAF senzori – Senzori i matjes së ajrit i cili e kyç turbinën duke i treguar se në çmasë duhet të kyçet.

MAP senzori – Senzori i matjes së shtypjes i cili e shkyç turbinën duke i treguar se në çmasë duhet të shkyçet.

Alternator – Dinamo – Makinë që shndërron energjinë mekanike në energji elektrike, gjenerator elektrik. Dinamo dore. Dinamo automobili (biçiklete). Dinamo me rrymë të vazhdueshme (me rrymë të pandryshueshme). (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 337).

Kompresor i klimës – Pajisje që shërben për të ngjeshur a për të shtypur ajrin, avullin ose gazrat; ngjeshës. Kompresor ajri. Cilindri (pistoni) i kompresorit. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 856).

Rrip dhëmbëzor – Rripi i motorit me djegie të brendshme i cili e vë në funksion motorin me pika të ndezjes. tek. Shirit i ngushtë prej lëkure ose prej një lënde tjetër i qepur si rreth, që shërben për ta kaluar lëvizjen rrotulluese nga një rrotë në tjetrën. Rrip lëkure (gome). Rrip transmisioni. Rripi i makinës (i traktorit). I vuri rripin. I doli (iu këput) rripi. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1703).

Zupçanik – Dhëmbzori – Pjesë e cila e vihet në lëvizje nëpërmjet rripit me dhëmbë.

Pompa e ujit – Pompa e cila e qarkullon ujin dhe e ftoh motorin me djegie të brendshme në sistemin e ftohjes me ujë.

Zamajci – Volani i motorit me djegie të brendshme.

Llamella – Pjesë e cila vendoset te volani i motorit me djegie të brendshme dhe e vë në lëvizje automjetin nëpërmjet marshit.

Korpa e llamellës – Pjesë e cila e mban lamelën në volan dhe e ndihmon shkyçjen e lamelës nëpërmjet kuplungut.

Menjaqi manual – Marshi manual i automjeteve

Menjaqi automatik – Marshi automatik i automjeteve

Shallteri – Pjesë e cila i ndërron shpejtësitë e marshit.

Angllaser – Pjesë e cila e ndez motorin me djegie të brendshme.

Dërzhaqi i motorit – Mbajtësi i motorit

Dërzhaqi i menjaqit – Mbajtësi i ndërruesit.

Diferencial – Bosht - Pjesë e makinave, e mjeteve dhe e veglave të punës, që ka trajtën e një druri të rrumbullakët dhe që shërben për të bashkuar rrotat ose pjesë të tjera që rrotullohen a

që lëvizin. Boshti qendror (kryesor). Boshti i qerres. Boshti i dërstilës (i mullirit). Boshti i çadrës. Makinë me dy boshte. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 167).

Kardani – Pjesë e cila e vë në lëvizje rrotat e prapme të automjetit

Centërllageri – Pjesë e cila e mban në qendër lëvizëzin e rrotave të prapme të automjetit.

Zgllobi i brendhshëm – Nyje e brendshme që ngjitet me marshin

Zgllobi i jashtëm – Nyje e jashtme që vendoset në pjesën e rrotës së automjetit.

Kryq i pollosovinës – pjesë e cila vendoset brenda nyjës dhe e mban në pjesën që i bashkon nyjën e brendshme dhe të jashtme.

Pollosovina – Pjesë e cila i bashkon nyjën e brendshme dhe të jashtme.

Trapi – Pjesët që e mbajnë automjetin dhe rrotat e automjetit.

Ura e trapit – Ura që i mban pjesët e vendosura që e mbajnë automjetin.

Vilushka - Piruni

Jabuqica - Mollëza

Spona – Pjesë e cila vendoset te rrota dhe i ndihmon volanit ta kthejë rrotën në të majtë dhe të djathtë.

Llageri – **Kushineta** -

Disku - tek. Pjesë e një aparati, e një makine a e një mekanizmi, e cila ka trajtën e një pjate, të një sferë të shtypur nga të dyja anët ose të një rrethi; çdo gjë që ka një trajtë të tillë. Disqe të dhëmbëzuara. Disqet e traktorit. Disqet e biçikletës. Ndërroi diskun. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Paknet – Frenat e automjetit me disk.

Gurtnet – Frenat e automjetit pa disk.

Amortizerat – **Amortizatorët** - Pajisje ose pjesë e posaçme, që shërben për të zbutur forcën e goditjeve ose të lëkundjeve në makinat, aparatet, armët etj. Amortizatorët e makinës (e topit). Amortizator me vaj. Susta e amortizatorit.

Spiralet – Spiralet e amortizatorëve - tek. Përcjellës ose tel me përdredhje të shumta në trajtën e kërmillit. Spirale metalikë. Spiralja e ngrohëses.

Cilindri i frenave.

Cilindri i kvaqillës – Cilindri i kupllungut.

Zorra e frenave – Gypi i frenave.

Shtrafi – Bulon - Bosht i vogël metalik, me një kokë dhe me disa vjaska ku vidhohet dadoja a kundërvridha, i cili shërben për të mbërthyer fort pjesë të ndryshme. Bulon shtrëngues. Fabrika e gozhdëve dhe e bulonave. Shtrëngo (liroj) bulonin.

Matica – Dado e bulonës - Kundërvridhë. Shtrëngo (liroj, vidhos, zhvidhos) dadon.

Vaji - Lëng i trashë dhe i yndyrshëm, më i lehtë se uji, që nxirret prej farave a prej kokrrave të disa bimëve (si luledielli, ulliri, kikiriku, etj.), prej bimësh të veçanta, prej disa kafshësh ose nga përpunimi i disa mineraleve e i naftës dhe që përdoret për ushqim, në industri, në mjekësi etj. Vaj i pastër (i kulluar). Vaj i mirë vaj ulliri. Vaj i trashë. bised. vaj recini. Vaj i djegur. tek. vaj makinash i përpunuar. Vaj ulliri (kikiriku, luledielli, misri). Vaj peshku. Vaj balene. Vaj recini. Vaj arrash (bajamesh). Vaj liri (dafinë, dëllinje). Vaj makinash. Vaj flokësh. Vaj plazhi. Vaj pushke vaj që përdoret për të pastruar pushkët, automatikët etj. dhe për të lyer pjesët metalike të tyre që të mos ndryshken. Bojë vaji bojë e shkrirë në një lëng të tillë. Fabrikë (mulli) vaji. Ngjyrë vaji. Fërgoj (skuq) me vaj. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2104).

Filtër i vajit – Filtër - Mjet (aparaturë, letër, cohë etj.), që shërben për të pastruar lëngjet ose gazet, duke u hequr atyre gjërat e panevojshme a të dëmshme; kullorë; site. Filtri i benzinës (i naftës). Filtër uji. Filtër ajri. Pastroj filtrin. Cigare me filtër cigare që ka në krye një pjesë si shtupë, e cila pengon nikotinën. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 471).

Filtër i ajrit

Filtër i naftës

Filtër i klimës

ÇELËSAT

Çekiçi – Çekani - Vegël dore, që përbëhet nga një kokë metali ose druri (në njërën anë e rrafshët e në tjetrën me majë) e nga një bisht dhe që shërben për të mbërthyer ose për të goditur a për të rrahur diçka. Çekan hekuri (druri). Çekani i farkëtarit (i këpucarit, i muratorit). Çekani i gjeologut. Çekan alpinistësh. Çekan për gurë. Bishti i çekanit. Koka (maja) e çekanit. Flamuri me drapër e çekan. Ngul (mbërthej) me çekan. I bie me çekan. Kalit me çekan. Punoj me çekan. Rreh si çekan. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 250).

Patenti – Gedore – Çelës me patentë.

Nastavaku – Shtojcë - Ajo që i shtohet diçkaje kryesore, ajo që shërben për të plotësuar diçka tjetër që është kryesore; diçka që nuk qëndron më vete, por plotëson diçka tjetër kryesore; shtesë e vogël (edhe fig.). Shtojcë druri (hekuri). Shtojcë bujqësore. I vë një shtojcë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1932).

Zgllobi – Nyje e çelësit - tek. Pjesë e një mekanizmi ose e një pajisjeje, e përbërë nga disa vegla më të thjeshta të lidhura ndërmjet tyre. Nyjat dhe mekanizmat e traktorit. Prodhimi (montimi) i nyjave. Zbërthimi i nyjës në pjesë. Nyjë elektrike pika ku bashkohen disa përcjellës në një qark elektrik. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1280)

Rruçka – Dorëza e çelësave patentë – Dorezë -

Imbusi – Çelës i cili me dhëmbë milimetrike hyn në bulonin adekuat.

Motorcangle – Dana -

Shpicangle – Çelës me maje në formë të gjatë i dedikuar për të kapur pjesët ku nuk mund të ndërhyhet me çelësa të tjerë.

Cicangle – Çelës i mprehtë për të prerë instalime.

Blokçangle – Çelës i dedikuar për të bllokuar zorrë të ndryshme të veturave, deri sa të punohet të mos pik ujë, lëndë djegëse apo glicerinë e frenave.

Rrollçangle – Çelës i dedikuar për të liruar bulona të mëdhenj ku nuk mund të lirohet me çelësa të ndryshëm.

Okasti – Çelës në formë rrethore me milimetra i dedikuar për të liruar bulonat e ndryshëm varësisht prej diametrit të tyre.

Vilushkasti – Çelës në formë piruni i dedikuar për të liruar bulonat e ndryshëm, zakonisht ku nuk mund të hyjnë çelësat e tjerë dhe forma e tij e pirunit ndihmon në lirimin e tyre.

Zvezdasti – Çelës në formë rrethore por me trup të drejtë me milimetra i dedikuar për të liruar bulonat e ndryshëm varësisht prej diametrit të tyre.

Shvajc aparat – **Aparat saldimi** - Veprimi sipas kuptimit të foljes SALDOJ. Saldim elektrik. Saldim me oksigjen. Saldimi i pjesëve metalike. Punime saldimi. Tegeli i saldimit. Doreza e saldimit. Reparti i saldimit. Bëj saldimin e diçkaje. 2. Mënyra si janë ngjitur dy pjesë metalike duke i salduar; vendi ku është bërë ngjitja e dy pjesëve metalike me oksigjen ose me elektrik. Saldim i mirë (i keq, i fortë). Saldimet e gypave (e kazanit). U këput te saldimi. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1730).

Presë – Makinë e posaçme që shërben për të përpunuar diçka ose për t'i dhënë formë me anë të shtypjes. Presë horizontale. Presë mekanike (hidraulike). E futi (e vuri) në presë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1543).

Dizalicë – **Lift** – **Vinç** - Makinë e fuqishme, me një krah të gjatë të metaltë, që është i lëvizshëm dhe që shërben për të ngritur, për të ngarkuar e për të shkarkuar pesha të rënda. Vinç i fuqishëm. Vinç i lëvizshëm (lëvizës). Vinç lundruar bigë. Krahu i vinçit. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2167)

Brucalicë – Mjet për të prerë metale të ndryshme.

Burmashinë – Mjet për shpuarje.

Pishtol – Mjet i cili punon me ajër të kompresorit dhe shërben për të liruar apo shtrënguar bulonat e ndryshëm.

Çeliçna çetka – Brushë e çelikut e cila shëben për pastrimin e pjesëve të ndryshme.

Heblla – Mjet i gjatë dhe i fortë i çelikut i cili shërben si levë për ta përdorur forcën në pjesë të ndryshme të veturave.

Daltë – Vegël prej çeliku me majë shpatuke e të mprehtë dhe zakonisht me dorezë druri, që përdoret për të gdhendur drurin, për të latuar gurin, për të prerë teneqenë etj. duke e rrahur me çekiç. Daltë e ngushtë. Daltë guri. Gdhend (latoj) me daltë. * Ia la në daltë dikujt u tregua më i zoti e më i shpejtë se dikush tjetër, ia la në dorë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 288).

Shtrafciger – **Kaçavidë** - Vegël e metaltë, si daltë e hollë dhe e ngushtë, me dorezë të veshur, që përdoret për të shtrënguar e për të liruar vidat. Shtrëngo (liro) me kaçavidë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 756).

Kompresor – Pajisje që shërben për të ngjeshur a për të shtypur ajrin, avullin ose gazrat; ngjeshës. Kompresor ajri. Cilindri (pistoni) i kompresorit. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 856).

Reduktor – Mjet me të cilin reduktohet diametri i njërit çelës në tjetrin.

Stegë – **Shtrënguese** - Vegël a pjesë vegle që shërben për të shtrënguar diçka. E vë në shtrënguese. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1938).

Diagnozë – **Diagnostikimi i veturave** - Njohja e thelbit dhe e shkaqeve të një gjendjeje a të një dukurie shoqërore sipas shenjave që shfaq. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 330).

3.1.5.2. ZEJTARËT E KARROSERISË

Zejtaria e karrocerisë sikur edhe ajo e automekanikëve ka marr një zhvillim të hovshëm pas çlirimit të Kosovës. Në zhargonin popullor, këtë veprimtari e quajnë limari. Kjo është një veprimtari e cila është mjaft e kërkuar por edhe një zanat i vështirë siç e përshkruajnë zejtarët. Kjo për faktin se ata gjatë gjithë ditës i janë të ekspozuar pluhurit dhe ngjyrave të ndryshme të cilat janë edhe të dëmshme për shëndetin. Gjuha e tyre nuk dallon shumë në etimologjinë e fjalëve me automekanikët, sepse fjalët e tyre burimin zakonisht e kanë në gjuhët sllave, e disa edhe në gjuhën e prodhuesve të veturave. Një dallim esencial që vetë zejtarët e përshkruajnë është se kanë dallime të mëdha gjuhësore kur shkojnë të blejnë pjesë në Shqipëri dhe thonë se “me ata nuk mund të kuptohemi sepse në Shqipëri për pjesët e veturave i kanë fjalët nga italishtja”. Zejtarët e kanë të vështirë të përdorin gjuhën letrare sepse gjuha e profesionit zakonisht dallon shumë nga letrarja. P.sh. dritave të mjegullës i thonë “magllenkë”, një fjalë sllave që e përshkruan mjegullën. Ose, xhamit të parë të automjetit i thonë “shofershajbe” që etimologjinë e ka në fjalën gjermane.

Krillë – Pjesë e vendosur në anën e majtë dhe të djathtë të veturës mbi rrotat e saj, e cila shërben si dekor.

Far – Fener - Dritat e veturave - Llambë ndriçimi me bateri, që vihet zakonisht në të dy anët e përparme të një makine, përpara motoçikletës a biçikletës për të ndriçuar rrugën gjatë udhëtimit natën. Fener makine. Ndez fenerët. Me fenerë të shuar. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 460).

Maska dekorative – Maskë që vendoset para veturës dhe shërben si dekor.

Maska lidhëse – Maskë e vendosur në pjesën e parë të veturës dhe shërben si lidhëse e të gjitha pjesëve dekorative përpara veturës.

Branik – Mbrojtës që vendoset para dhe pas veturës.

Magllenkë – Dritat e mjegullës së veturës.

Haubë – Pjesë që vendoset në pjesën e parë të veturës mbi motorin e veturës.

Shofershajbe – Xham i parë i veturës.

Tavan – Kulmi i veturës

Derë – Dyert e veturës

Dritare – Dritaret e veturës

Tapicier – Pjesa dekorative brenda dyerve të veturës.

Sajllë e xhamit – Pjesë e cila i ndihmon në hapjen dhe mbylljen e dritares

Stub – Shtyllë e veturës

Gepek – Pjesë e prapme, bagazh i veturës - Plaça e sende të ndryshme, të futura në valixhe, të mbështjella etj., që merr me vete dikush kur udhëton me një mjet. Bagazhet e dorës. Vend (vagon) për bagazhe. Dhoma e bagazheve. Biletë bagazhi. Ngarkoj bagazhin. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 83).

Prag – Prag i veturës

Shtop – Drita të prapme

Ngjyrë – Ngjyrë e veturës - Vetë fizike e një trupi për të thithur një pjesë të dritës që bie mbi të dhe për ta pasqyruar pjesën tjetër me rreze të një gjatësie të caktuar, që shkaktojnë një ndijim pamor në sy. Ngjyrë e ëmbël. Ngjyra të forta (të ndezura). Ngjyra të qarta (të mbyllëta, të hapëta). Ngjyrë e kuqe (e gjelbër, e verdhë...). Ngjyrë trëndafili (qielli, deti, plumbi, gruri...). Ngjyrë gështenjë (vishnje). Ngjyrat e ylberit. Laps me ngjyrë. Film me ngjyra. Merr ngjyrë. Humbet ngjyrën. Ndryshon ngjyrë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1264)

Nitro – Përzierës me ngjyrë.

Llak – Llak i ngjyrës - Rrëshirë e tretur në alkool, në vaj etj., me të cilin lyejnë sende të ndryshme (zakonisht orendi) për t'i ruajtur nga prishja, për t'u dhënë shkëlqim etj. Shtresë llaku. Lyej me llak. Veshja e telave me llak. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 1034).

Furrë – Furrë e lyerjes së veturës - Ndërtim i veçantë dhe i mbyllur për të shkrirë minerale, për të nxjerrë a për të përpunuar lëndë të ndryshme që kërkojnë temperaturë të lartë. Furrë termike. Furrë elektrike. Furrë e lartë furnaltë. Furrë shkrirjeje. Furrë çeliku (gize). Furra e tharjes. Furrë gëlqereje. Furrë tullash (tjegullash). Përpunoj (shkrij) në furrë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 520).

Maskë – Maskë që e vendos zejtari për lyerjen e veturës.

Pishtol – Mjet me të cilin e përdorin për lyerjen e veturës.

3.1.5.3. UJËSJELLËSIT

Profesioni i ujësjellësit është i një rëndësie të veçantë për shkak se uji është pjesë e pandarë e jetës sonë, qoftë për pije, qoftë për higjienë. Fjalët që i përdorin ujësjellësit janë:

Teshtik – Nga gjuha gjermane “T-stuck” – Gyp në formë të shkronjës T.

Vastervaga – nga gjuha gjermane “wasser wegge” – Mjet për matjen e nivelit.

Bryli – Gyp në formë të brylit

Kosa – Ypsilon – Gyp në formë të shkronjës Y.

Muf – Gyp në dy anë me bulonë.

Duplla niplli – Gyp me filetë në të dy anët.

Kolektor – Shpërndarësi - Kanal i gjerë, i zbuluar a i mbuluar ose gyp i madh, zakonisht i nëndheshëm, në të cilin derdhen ujërat, lëngjet a gazrat e ndryshme nga kanale tjera më të vogla ose nga gypa anësorë. Kolektor kryesor. Kolektor kullues. Kolektor nafte (avulli, gazi). Pastroj (thelloj) kolektorin. Derdhet në kolektor. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 849).

Koka përfunduese – Bateri përfundimtare.

Kaseta.

Gozhdë - Kunj metali me përmasa të ndryshme, që është në njërën anë me majë dhe në anën tjetër me kokë dhe që ngulet për të mbërthyer diçka, për të mbathur kuaj, për të varur në të sende të ndryshme etj. Gozhdë e madhe (e vogël, e trashë, e hollë). Gozhdë e shtrembër (e ndryshkur). Gozhdë trarësh (këpucësh, potkonjsh). Koka (maja) e gozhdës. Fabrika e gozhdëve. Ngul (mbërthej) një gozhdë. Heq (shkul) gozhdën. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 566).

Shirit - Rrip i hollë e i ngushtë prej pëlhure, prej letre, prej metali etj., që përdoret për punë të ndryshme, për zbukurime, në teknikë etj.; gajtan. Shirit i hollë. Shirit i gjatë (i ngushtë, i gjerë). Shirit i bardhë (i verdhë). Shirit i zi rrip prej pëlhure të zezë që vihet në krah ose në jakën e xhaketës në shenjë zie. Shirit i kuq rrip prej pëlhure të kuqe që vë në krah dikush kur është ngarkuar me një shërbim të caktuar. Shirit i çeliktë. Shirit magnetik. spec. rrip i hollë e i ngushtë prej një lënde të posaçme, i mbuluar nga njëra anë me një shtresë me veti elektromagnetike, që shërben për të regjistruar zërin ose figurat. Shirit magnetofoni. spec. Shirit letre (mëndafshi, kadifeje). Shiriti i telegramit rrip letre i mbledhur rrumbullak, mbi të cilin aparati marrës shtyp tekstin e një telegrami. Shirit makine rrip i ngushtë prej pëlhure të ngjyrosur, që përdoret në makinat e shkrimit. Shirit mitralozi. usht. rrip metalik me fole për fishekët e mitralozit. Shirit me fishekë. Shirit filmi rrip i hollë prej lënde të posaçme, i mbuluar me një shtresë të ndjeshme ndaj dritës, që përdoret për të fotografuar. Shirit shërbimi. usht. rrip i gjerë prej pëlhure të kuqe me mbishkrimin përkatës, që vë në krah ushtaraku gjatë shërbimit. Shiriti i mbërritjes. sport. rrip pëlhure që vendoset në vendin e mbërritjes së atletëve në një garë vrapimi (ai që prek shiritin i pari me gjoks, fiton garën). Shiriti i librit rrip i ngushtë prej mëndafshi, që shërben për të shënuar në ç'faqe është ndërprerë leximi në një libër. Fustan me shirita. Pres shiritin (e inaugurimit të një vepre ndërtimi, të një ekspozite etj.). Lidh flokët me shirit. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1843).

Gyp i ujit, kanalizimit - Cilindër prej metali, prej qelqi, prej çimentoje etj. me përmasa të ndryshme, i zbrazët përbrenda dhe i hapur nga të dyja anët ose nga njëra anë, që përdoret si mjet a si pajisje në mekanizma e aparate të ndryshme për të kaluar lëngjet, gazet, avujt etj.; pajisje e tillë me këtë trajtë; tub. Gyp i drejtë (i kthyer). Gyp uji. Gyp sobe. Gypi i gazeve. Gyp xhami (teneqeje, llastiku). Gypi i teleskopit. Gypi i llambës. bised. poçi i llambës. Gypi i lugut të mullirit. Gypi i kazanit të rakisë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 594).

Alkaten – Gyp i ujit i zi.

Spojka – Lidhëse - Rrip i hollë e i gjatë prej lëkure, fije bari a zhuke, thupra etj. të përdredhura së bashku, që përdoren për të lidhur e për të shtrënguar diçka; liktyrë. Lidhëset e duajve. Lidhëse për shartesat. Bën lidhëse. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 994).

Pollaspojka – Gjysmë lidhëse.

Bryl niplla – Një anë me filetë dhe një anë me bulon.

Ventil.

Shtopna – Mbyllëse - Tapë, kapak i vogël etj. për të mbyllur një shishe a një enë tjetër; kapak. Mbyllëse prej misërishteje (prej lecke). I vuri (i hoqi) mbyllësen. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 1101).

Lavabo – Lavaman

Shole.

Tush kabina.

Tush kada – Tush vaska.

Kada – Vaskë - Enë e madhe dhe e hapur si govatë, prej porcelani a prej zinku, ku futen e lahen njerëzit. Vaska e banjës. Hyri në vaskë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2117).

Tush bateri.

Bateri lavabo – Bateri lavaman.

Mbajtës tushi.

Telefon tushi – Tush në formë të telefonit.

Mbajtës peshkiri – Mbajtës peshqiri

Mbajtës shamponi.

Mbajtës sapuni.

Mbajtës letre.

Brushë - shih FURÇ/Ë,~A. Brushë këpucësh. Brushë rroje. Brushë dhëmbësh. Përdorëse me qime të dendura e të ashpra, me të cilën pastrojmë, lyejmë a fshijmë diçka. Furçë rrobash. Furçë dhëmbësh. Furçë këpucësh. Furçë rroje. Furçë gëlqereje. Pastroj (lyej fshij) me furçë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 519).

Keramika – Qeramika - Enë, tjegulla, sende zbukurimi etj., të bëra prej deltime të mbrujtur e të pjekur në furrë. Qeramikë e zakonshme tulla, tjegulla etj. Qeramikë e hollë sende prej porcelani. Qeramikë artistike. Qeramikë e pikturuar. Punimi i qeramikës. Bojë qeramike. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1598).

Ngjitësi - Që shërben për të ngjitur dy gjëra; që është i lyer me një lëndë e cila ngjit. Lëndë ngjitëse. Gomë ngjitëse. Letër ngjitëse (për miza) rrip letre i lyer me një lëndë veshtullore për të kapur mizat. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1263).

Fuga.

Hidro izolim.

Reshetka – Ujëmbledhësi - Që shërben për të mbledhur ujë për ujitje. Pellg ujëmbledhës. Gropë (vatër, vijë) ujëmbledhëse. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2082).

Llajsne – Mbuluese kozmetike - Që shërben për të mbuluar diçka; që përdoret si mbulesë. Kapak (xham) mbulues. Lëndë mbuluese. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 1097).

Bojler.

Sifon - Gyp i lakuar me dy krahë, me gjatësi të ndryshme, që shërben për të kaluar një lëng nga një enë e vendosur më lart në një enë të vendosur më poshtë ose për të kaluar ujë a një lëng tjetër nga një vend më i lartë në një më të ulët, aty ku nuk bëhet dot kanal. Sifon mbi lumë. Parimi i sifonit. Gjatësia e sifonit. Ndërtuan një sifon. Gyp i lakuar në trajtën e shkronjës S, që vendoset shtrirë aty ku shkarkohen ujërat e zeza ose të papastra për të ndaluar daljen e erës së keqe me anë të ujit që mbetet në lakesën e poshtme të gypit. Sifoni i banjës. Tapa e sifonit. I vuri sifon. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1748).

Silikon – Ngjitës i cili kur forcohet bëhet si gomë.

Kuçinë – Lija.

Teflon – Mbulues për të eliminuar rrjedhjet.

Rollacangle – Vegël pune e cila përdoret për të liruar dhe shtrënguar gypat.

Reducir – Reduktor.

Es – Gyp i lakuar në trajtën e shkronjës S, që vendoset shtrirë aty ku shkarkohen ujërat e zeza ose të papastra për të ndaluar daljen e erës së keqe me anë të ujit që mbetet në lakesën e poshtme të gypit. Sifoni i banjës. Tapa e sifonit. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1748).

Sahat i ujit – Ujëmatësi - Mjet që shërben për të matur sasinë e ujit të harxhuar ose nivelin e ujit. Që shërben për të matur sasinë e ujit të harxhuar ose nivelin e tij. Qelq ujë matës gyp i shkallëzuar prej qelqi që lidhet me një enë të mbyllur për të matur nivelin e ujit. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2082).

Ventil jo kthyes.

Ventil sigurues.

3.1.5.4. ARGJENDARËT

Argjendaria ka shumë herët ka qenë një zejтари mjaft e përhapur. Në shumë qytete të Kosovës dhe të Shqipërisë ajo ishte e zhvilluar. Kështu, sipas portalit të përditshëm kosovar “Bota Sot” në artikullin e publikuar më datën 4 gusht 2010, ata në titullin **“Shqiptarët ishin mjeshtër të zotë të argjendarisë dhe zejtarisë”**, gjendjen e argjendarisë e përshkruajnë se “argjendarët e qyteteve të Shkodrës, Prizrenit dhe Elbasanit punonin arin dhe argjendin dhe prodhonin stoli për gra, si vathët, unazat, gjerdanë, pafta brezash ose zbukuronin armët e burrave, si kondakët e hutave, dorëzat e jataganëve e kobureve harbimet e vezmet ose dekoronin me ornamente të ndryshme objekte shtëpiake dhe kishtare” (Musliaj, 4 oct 2010). Më tej ai shkruan se numri i argjendarëve gjatë shekullit ishte mjaft i madh, ku në Shkodër kushte rreth 100 punishte argjendarie ndërsa në Elbasan rreth 60. Këtë profesion ndryshe e kanë quajtur edhe profesion në lulëzim (Musliaj, 4 oct 2010).

Gjuha e argjendarëve është mjaft komplekse. Varësisht prej kohës ka edhe ndryshime në emërtimin e mjeteve në zhargonin e tyre gjuhësor.

Fjalët që ata i përdorin për mjetet e tyre janë:

Pinceta – Piskatore - Vegël e thjeshtë prej metali, si një mashë e vogël, që përdoret për të kapur gjëra të imëta. E kapi me piskatore. Shkulte qimet me piskatore. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1488).

Dana të rrafshëta.

Burumlia – Dana të rrumbullakëta.

Gërshëra për metale - Vegël e përbërë nga dy krahë të mprehtë çeliku, që lëvizin të kryqëzuar rreth një boshti të përbashkët për të prerë pëlhurë, letër, llamarinë etj. ose për të

krasitur pemët. Gërshërë e vogël (e madhe). Gërshërë flokësh. Gërshërë rrobaqepësish. Gërshërë thonjsh. Gërshërë për krasitje. Gërshërë për prerjen e metalit. Dorezat e gërshërës. Pres (qeth) me gërshërë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 548).

Mikroskop - Mjet optik i përbërë prej disa thjerrëzash të fuqishme, i cili përdoret për të zmadhuar ose për të parë trupa të vegjël që nuk mund të shihen vetëm me sy. Mikroskop elektronik aparat optik shumë i fuqishëm, që zmadhon deri në një milion herë. Shoh me (në) mikroskop. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 1138).

Brener për saldim.

Shubleri – Lloj matësi.

Ngjitës - Lëndë veshtullore ose përzierje e disa lëndëve, me të cilën lyhen sipërfaqet e dy fletëve a të dy pjesëve për t'i ngjitur; zamkë. Ngjitës i lëngshëm (i trashë). Lyej me ngjitës. Tutkalli është ngjitës i mirë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1263).

Gravurë - Arti i gdhendjes mbi sipërfaqen e sheshtë të një sendi të fortë (prej metali, guri, druri etj.) me anën e një dalte a të lëndëve kimike, për ta zbukuruar atë, për ta përdorur për riprodhimin e një veprë grafike etj. Gravurë në gur (në dru, në metal, në shkëmb). Vizatim a mbishkrim i gdhendur në sipërfaqen e sheshtë të një sendi të tillë, si edhe riprodhimi i tij në letër; përmb. tërësia e veprave të këtij lloji. Gravurë e bukur. Gravurë me ngjyra. Ekspozita e gravurës. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 571).

Thikat për gravurë.

Gravurë elektronike.

Thikat për gdhendje të metalit.

Gramograf – Matës i peshës në gram.

Makinë CNC për gravurë dhe prerje.

Makina me laser për gravurë dhe prerje.

Filtri për ventilim – Respirator.

Pllaka asbesti – **Asbest** - Mineral i përbërë prej fijesh të holla, që i qëndron shumë veprimi të nxehtësisë e të acideve, që nuk e përçon rrymën elektrike dhe që përdoret gjerësisht në industri e në ndërtim. Mineral asbesti. Veshje prej asbesti. Fabrika e pasurimit të asbestit. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 60).

Konus – Formuesi i unazës.

Kiselinë – **Acid** - Bashkim kimik, zakonisht i lëngshëm, me shije të thartë e me veti gërryese, që përmban hidrogjen dhe që me metalet jep kripëra; thartor. Acid sulfurik (borik, acetik...). Acid yndyror (organik ...). Acid i fortë (i holluar). Acid akumulatorësh. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 4).

Varaksi – Lloj i acidit.

Alkooli etilik - Bashkime organike, që dalin nga hidrokarburet duke zëvendësuar një a disa atome të hidrogjenit me grupin prej një atomi oksigjeni e një hidrogjeni. Alkool parësor (dytësor). Alkool druri. bised. Pije e fortë dehëse. Dëmet e alkoolit. Pi alkool. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 25).

Dylli për kallëp.

Kecela – për mbledhjen e pluhurit.

Polirka – Motor për polirim.

Llot – Ari për saldim të arit dhe argjendit.

Lehem – Legura për saldim.

Fille – Për polirim të arit.

Izlivnik – Për derdhje të metalit të shkrirë.

Walc – Makina kryesore për përpunimin e arit.

Pota – Enë për shkrirje.

Pullt – Vitrina për mallra të arit.

Limat e formave të ndryshme.

Grirëse diamanti për gdhendje.

Argon - Element kimik, gaz i plogët, i rrallë, pa ngjyrë e pa erë, që gjendet në ajrin e atmosferës dhe që përdoret zakonisht për mbushjen e llambave elektrike (simboli A). Llamba me argon. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 47).

Plin – gaz.

Oksigjen - Element kimik, gaz pa ngjyrë, pa erë e pa shije, i cili përbën rreth një të pestën e ajrit, është i domosdoshëm për frymëmarrjen e për djegien dhe, kur bashkohet me hidrogjenin, formon ujin (simboli O). Oksigjen i lirë. Oksigjen i lëngët. Oksigjeni i ajrit (i ujit). Drita (flaka) e oksigjenit. Atomët e oksigjenit. Ujë oksigjeni. Ngjitje me oksigjen. I dhanë oksigjen të sëmurit. * I jep oksigjen dikujt libr. keq. e ndihmon a e nxit dikë për të bërë një të keqe, i fryn zjarrit. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1302).

3.1.5.5. ZDRUKTHËTARËT

Zdrukthëtaria është një zeje e përhapur në komunën e Rahovecit. Ky lloj i zejes përveç që prodhon dyer dhe dritare të ndryshme, për shkak se komuna e Rahovecit është e zhvilluar me kulturën e vreshtarisë dhe prodhimit të verës dhe produkteve tjera alkoolike në të njëjtën kohë, zdrukthëtarët për shkak e prodhojnë fuçitë për verë dhe raki ndryshe i quajnë edhe vozaxhi (voz e quajnë fuçinë).

Fjalët që ata i përdorin janë:

Vozë – Fuçi e në disa raste e quajnë edhe hordov (kjo nga gjuha bullgare) - Enë druri e madhe, e rrumbullakët e me bark të gjerë, që ndërtohet me dërrasa të perkulura e të shtrënguara me rrathë hekuri dhe që përdoret për të mbajtur bulmet, verë, turshi etj.; sasia e lëndës sa nxë një enë e tillë. Vozë djathi. Vozë vere. Reparti i vozave. Dru voze. Rrathë

vozash. Mbush (zbraz) vozën. Gjëmon voza që s'ka verë (që është bosh). f.j.u. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2181).

Dega

Unaza e vozit – Rrethi i vozit – Rrethi i fuçisë.

Kombinerkë me tre operacione – Plan drejtues e tre operacione

Kombinerkë me pesë operacione – Plan drejtues me pesë operacione

Dikt

Bansek – Sharrë shiritore - Vegël me përmasa, me trajta e me pajisje të ndryshme, që ka si pjesë kryesore një rrip a një disk prej çeliku me dhëmbë të mprehtë dhe që përdoret për të prerë dru, metale e trupa të tjerë të fortë, duke u vënë në lëvizje me forcën e krahut ose me një forcë tjetër; rripi a disku prej çeliku i kësaj vegle, që shërben për të prerë; makinë me një vegël të tillë. Sharrë e madhe (e vogël). Sharrë elektrike. Sharrë prerëse. min. Sharrë dore (krahu). Sharrë shirit. Sharrë disk. Sharrë hekuri (druri). Sharrë trupash. Sharrë mermeri. Doreza (fleta) e sharrës. Dhëmbët e sharrës. Pluhur sharre. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981).

Tallash – Byk - Ashklat e vogla dhe pluhuri që dalin nga druri a nga një lëndë tjetër kur e sharrojmë, kur e zdrugojmë etj., copërat që bien gjatë sharrimit, gjatë zdrugimit a gjatë prerjes së drurit a të një lënde tjetër. Tallash i trashë (i hollë, i imët). Tallash druri (hekuri, bakri). Shtresë tallashi. Shfrytëzim i tallasheve. Dërrasë prej tallashi. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1819).

Strugë i dorës - Mbulesë e leshtë që hidhej krahëve si rrobë ose që përdorej si shtrojë; lloj bërruce e bardhë, që e përdornin barinjtë në disa krahina të Veriut të Shqipërisë. Strugë e bardhë. Struga e Zadrimës. Hodhi (shtroi) strugën. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1797).

Përdësëz – Zdrukth - Vegël dore prej druri a prej metali, me një thikë të gjerë, që përdoret për pastrimin, rrafshimin e drejtimin e dërrasave e të pjesëve të tjera prej druri ose për të hapur kanale në to. Zdrukth i ngushtë. Zdrukth i trashë (tek) zdrukth që heq shtresën e parë, të trashë të drurit. Zdrukth i lakuar zdrukth që e ka fundin të lakuar. Zdrukth drejtues. Zdrukth pastrues. Zdrukth ulluk zdrukth me fund të lakuar për të bërë kanale në dërrasë. Zdrukth qorr zdrukth i ngushtë që përdoret për zdrukthimin e kanaleve. Thikë zdrukthi. Mbeturina zdrukthi. Pllakë zdrukthi pllakë e bërë me tallash. E hëngri pak me zdrukth dërrasën. * E futi në zdrukth dikë ia rregulloi mirë dikujt, e gdhendi. Ka zdrukth të fortë dikush. shih Ka limë të fortë dikush te LIM/Ë,~A. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2222).

Makinë prefëse -

Fazallëk – Traversë vertikale - Tërthorëse, kryqësore. Traversat e hekurudhës. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2018).

Ram – Kornizë - Parvaz i ngushtë, zakonisht prej dërrase e në trajtë katrori, katërkëndëshi etj., ku vihet një tablo, një fotografi, një pasqyrë etj.; parvazi bashkë me tablonë, fotografinë etj.; parvazi i dritares. Kornizë katrore (e rrumbullakët). Kornizë e hollë. Kornizë e lustruar. Kornizë allçie. Pasqyrë me kornizë. Vë (fut) në kornizë. Var kornizën. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 870).

Zemra – Nyja e Drurit

Belek – Bellovinë – Blanë - Urra e drurit. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 155).

Gunga – Nyja.

3.1.5.6. XHAMAPRERËSIT

Xhamaprerësit i takojnë grupit të zejtarëve të vjetër. Ky lloj i zejtarisë ka qenë i zhvilluar qysh herët. Familje të ndryshme kanë një traditë më tepër se një shekulli në këtë zanat. P.sh.

Portali Klan Kosova, më datën 30 nëntor 2016 në emisionin Ora 7 të këtij televizioni dhe në portal kanë publikuar videon me artikull “Familja Grezda, 100 vjet traditë si xhamaprerës” (Gaxheri, 30.11.2016). Ky profesion vazhdon të ushtrohet edhe sot. Fjalët që i përdorin janë:

Xhamllëk – Peshtah – Kornizë në formë të xhamit për nuse - Ndarje e madhe e një ane të dhomës, të ballkonit etj. me xham; dritare a kornizë e madhe me xham. Xhamllëku i shkallëve. Dhomë me xhamllëk. Ballkon me xhamllëk. Dollap me xhamllëk. Mbulesë (çati) me xhamllëk. Ndaj (rrethoj, mbuloj) me xhamllëk. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2196).

Elmaz – Vegël dore me një gur të vogël diamanti në majë, që përdoret për të prerë xhame. Pres me elmaz. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 425).

Xham - Qelq. Xham i pathyeshëm. Xham i tejdukshëm. Xham i tretshëm qelq që tretet në ujë. Xham shishesh. Xham qumësht qelq i bardhë e i marrtë që përdoret për llamba të posaçme, për abazhurë etj. Xham me ngjyrë. Enë xhami. Rërë xhami lloj rëre e imët, që përdoret si lëndë e parë për qelqin. Thyhet si xham. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2195).

Silikon – Ngjitës i cili kur forcohet bëhet si gomë.

Kit – Ngjitës për xham.

Ram – Kornizë - Parvaz i ngushtë, zakonisht prej dërrase e në trajtë katrori, katërkëndëshi etj., ku vihet një tablo, një fotografi, një pasqyrë etj.; parvazi bashkë me tablonë, fotografinë etj.; parvazi i dritares. Kornizë katrore (e rumbullakët). Kornizë e hollë. Kornizë e lustruar. Kornizë allçie. Pasqyrë me kornizë. Vë (fut) në kornizë. Var kornizën. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 870).

Llajsne – Mbuluese kozmetike.

Vakum – Formues i vakumit gjatë ngjitjes së xhamit

Elmaz kompas – Prerës xhami në formë të kompasit.

Burgji – Shpues i xhamit - Turjelë e vogël, që përdoret për të hapur vrima, për të nxjerrë tapat e shisheve etj. * Ia gjeti burgjitë (vidhat, barmat) shih te VIDH/Ë, ~A. Ia liroi burgjitë (vidhat) dikujt shih te LIROJ. I janë liru (i kanë luajtur) burgjitë (burmat, vidhat) dikujt shih te VEDH/Ë, ~A. Ia shtrëngoi burgjitë (vidhat) dikujt shih te SHTRËNGOJ. Ka luajtur nga burgjitë (nga vidhat) shih te VIDH/Ë, ~A. I shkanë burgjitë (vidhat) dikujt shih te SHKAS. Ka një burgji (vidhë) mangët shih te VIDH/Ë, ~A. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 199).

3.1.5.7. RROBAQEPËSET

Profesioni i rrobaqepësisë është mjaft i përhapur në komunën e Rahovecit. Zhargoni i gjuhës së tyre, për dallim prej zejeve të cekura më parë, nuk dallon shumë nga gjuha popullore dhe letrare shqipe. Fjalët që i përdorin zakonisht janë:

Gërshërët – Përdoren për prerje të materialit, për shkurtim të fustaneve - Vegël e përbërë nga dy krahë të mprehtë çeliku, që lëvizin të kryqëzuar rreth një boshti të përbashkët për të prerë pëlhurë, letër, llamarinë etj. ose për të krasitur pemët. Gërshërë e vogël (e madhe). Gërshërë flokësh. Gërshërë rrobaqepësish. Gërshërë thonjsh. Gërshërë për krasitje. Gërshërë për prerjen e metalit. Dorezat e gërshërës. Pres (qeth) me gërshërë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 548).

Makinë – Përdoret për qepje të materialeve të ndryshëm - Mjet i përbërë nga një tërësi pjesësh a veglash, që vihet në lëvizje me rrymë elektrike ose me lëndë djegëse dhe që shërben për të kryer një punë të caktuar, për të nxjerrë një prodhim duke përpunuar lëndë të parë, për të shndërruar një lloj energjie në një lloj tjetër etj.; mjet i përbërë prej disa pjesësh që vihet në veprim zakonisht me dorë për punë të ndryshme. Makinë bujqësore. Makinë mbjellëse (korrëse, shirëse, kositëse, grirëse). Makinë qepëse. Makinë larëse (tharëse, fshirëse). Makinë llogaritëse. Makinë elektrike (kibernetike). Makinë me avull (me motor). Makina e blojës.

Makinat e tezgjahut (e ngjyrosjes). Makinë shkrimi. Makinë rroje. Makinë për grirjen e mishit. Prodhimi i makinave. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 1051).

Gjilpëra – Nevojitet për qepje - Fill i hollë çeliku me majë të mprehtë e me vrimë në fund, që përdoret për të qepur; fill i tillë pa vrimë, që përdoret për t'u ngulur. Gjilpërë e hollë (e trashë). Gjilpërë qepëse. Gjilpërë kapëse karficë. Gjilpërë dore (makine). Gjilpërë me kokë gjilpërë pa vrimë e me një kokë të rrumbullakët në fund. Maja (vrime) e gjilpërës. Jastëku i gjilpërave. Qep me gjilpërë. Shkoj perin në gjilpërë. Ngul gjilpërën. Shpim me gjilpërë. mjek. akupunkturë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 618).

Gjilpëra dore – Nevojitet për qepje me dorë.

Shkumësi – Nevojitet për shenjën e masave të marra - Gur gëlqeror i butë dhe i bardhë, i formuar prej guaskash ose prej bimësh njëqelizore të detit, që përdoret në degë të ndryshme të industrisë kimike etj. Shkumës i bluar. Shtresë shkumësi. Shkop i vogël prej kësaj lënde ose i përgatitur prej lëndësh të tjera, që përdoret për të shkruar në dërrasën e zezë ose në një sipërfaqe tjetër me ngjyrë të errët. Shkumës i bardhë. Shkumës me ngjyra. Punishtja e shkumësit. Shkruaj me shkumës. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 1876).

Metër – Nevojitet për masën e materialit dhe të trupit - Rrip i ngushtë prej rrobe a prej lënde tjetër ose vizore prej druri, prej metali etj., që ka këtë gjatësi, ndahet në centimetra dhe përdoret si mjet për të matur gjatësinë e diçkaje. Metër çeliku. Metër zdrukthëtar. Mat me metër. I vuri metrin e mati me metër. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 1121).

Drugëza – Nevojitet për makinë që e mban penjtë në fund për qepje - Bosht i vogël e i hollë prej druri, që mbledh fillin e tjerrë me furkë; sasia e fillit të tjerrë të leshit, të pambukut etj. Që mund të mblidhet në këtë bosht. Drugë e lehtë (e rëndë). Rrotulla e drugës. Dredh drugën. Ka tjerrë dy druga lesh. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 380).

Brusha – Nevojitet për pastrimin e makinës ku mblidhen penjtë dhe copat e materialit në qepje.

Fletorja – Nevojitet për shënimin e masës së klientit dhe modelin çfarë dëshiron klienti -

Disa fletë letre, të qepura bashkë në njëren anë në mes dy kapakësh, që përdoren për të shkruar në to, për të vizatuar etj. Fletore shkrimi (vizatimi, bukurshkrimi, aritmetike). Fletore shënimesh. Fletore xhepi bllok i vogël për shënime. Fletorja e kujtimeve. Fletore me vija të gjera (me vija të ngushta, me katrorë). Kapaku i fletores. Shkruaj në fletore. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 488).

3.1.5.8. FRIZERET

Frizeret, sidomos në kohët e fundit janë mjaft të përhapura. Kjo për faktin se për çdo eveniment me rëndësi, zakonisht njerëzit shkojnë dhe rregullohen dhe mundohen të duken më të veçantë për paraqitjen e tyre të jashtme. Ata përdorin një gjuhë mjaft karakteristike si në vijim:

Gërshëra – Përdoren për prerjen e flokëve.

Krehër – Përdoret për krehjen e flokëve.

Shnolla – Përdoren për kapjen e flokëve.

Përparëse – Përdoret gjatë prerjes së flokëve.

Pompa – Përdoret për lagjen e flokëve.

Makinë për zgjatje flokësh.

Peglla për flokë – Përdoret për drejtimin e flokëve.

Pincetë për vetulla – Piskatore për vetulla, përdoret për heqjen e qimeve të vetullave.

Shminka – Grimi.

Karrige për uljen e klientit.

Llak për flokë.

Figaro – Përdoret për dredhjen e flokëve.

Maskara – Përdoret për lyerjen e qerpikëve.

Krem për fytyrë.

Dylli për depilim.

3.1.5.9. KËPUCËTARËT

Këpucëtaria është zeje mjaftë e vjetër. Kjo për shkak të nevojave të kamotshme të njerëzve për të veshur këpuca të ndryshme në këmbë. Në komunën e Rahovecit zejtarët e parë të këpucëve kanë filluar punën pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte familja e Xheladin Kabashit ajo e cila e ushtroi këtë zeje në Rahovec për dekada të tëra. Biri i Xheladin Kabashit, Ymer Kabashi, ende e ushtron këtë profesion në Rahovec. Ai tregon se këtë punë e kanë ushtruar qysh moti ndërsa ai vet përceç që ka filluar të punojë me babën e tij, provimin e këtij zanati e ka dhënë në vitin 1969 tek mjeshtri Abedin Rezniki, mjeshtri gjakovar dhe atëherë ka pas mjaftë punë. Por sot me zhvillimin e teknologjisë, për shkak të çmimit të këpucëve, njerëzit nuk kanë llogari të i riparojnë këpucët dhe për këtë arsye shihet si profesion në zhdukje.

Sipas Ymer Kabashit, këpucëtari së pari duhet të ketë makinë qepëse për lëkurë, e më pas vjen edhe materiali i lëkurës së përpunuar prej viçit dhe prej kalit.

Në zhargonin e këtij profesioni fjalët përdoren kështu:

Makinë qepëse për lëkurë

Lëkura e viçit ose e kalit -

Kallypat – Kallëp - Copë druri, a metali, me trajta e përmasa të caktuara, që shërben për t'u dhënë sendeve (këpucës, një pjese këmbimi, sapunit etj.) gjatë punimit formën që dëshirohet; formë, model. Kallëp i drunjtë (i metaltë). Kallëp bakri. Kallëp këpucësh (kapelash). Kallëp tjegullash. Kallëpe shkronjash. Reparti i kallëpeve. Vë (shtie, fut) në kallëp. Derdh (hedh) në kallëp. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Çekiçi – Çekani - Vegël dore, që përbëhet nga një kokë metali ose druri (në njërën anë e rrafshët e në tjetrën me majë) e nga një bisht dhe që shërben për të mbërthyer ose për të goditur a për të rrahur diçka. Çekan hekuri (druri). Çekani i farkëtarit (i këpucarit, i muratorit). Çekani i gjeologut. Çekan alpinistësh. Çekan për gurë. Bishti i çekanit. Koka (maja) e çekanit. Flamuri me drapër e çekan. Ngul (mbërthej) me çekan. I bie me çekan. Kalit me çekan. Punoj me çekan. Rreh si çekan. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 250).

Thikat – Thikë - Mjet i vogël, me një presë të gjatë të metaltë e me një dorezë prej druri a prej një lënde tjetër, që përdoret për të prerë bukë, mish, pemë, perime, në mjekësi etj. Thikë e mprehtë. Thikë buke. Thika e duhanit. Thikë operacioni. Thikë me majë. Thikë me dy presa. Thikë sharrrë. Doreza (presa, maja) e thikës. Tehu i thikës. Mpreh thikën. E preu (e griu, e theri, e çau) me thikë. I nguli thikën. I ra me thikë. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981).

Lima -

Danat -

Bizat – Fëndyell - Biza e këpucarit. Maja e bizës. Shpoj me bizë. Grep për të qëndisur. Qëndisje me bizë. Punon (qep) me bizë. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Gjilponat -

Gozhda me numra të ndryshëm - Gozhdë - Kunj metali me përmasa të ndryshme, që është në njërën anë me majë dhe në anën tjetër me kokë dhe që ngulet për të mbërthyer diçka, për të mbathur kuaj, për të varur në të sende të ndryshme etj. Gozhdë e madhe (e vogël, e trashë, e hollë). Gozhdë e shtrembër (e ndryshkur). Gozhdë trarësh (këpucësh, potkonjsh). Koka (maja) e gozhdës. Fabrika e gozhdëve. Ngul (mbërthej) një gozhdë. Heq (shkul) gozhdën. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981, f. 566).

Gjyni i këpucës

Kunja e drunit - Copë druri a metali, në trajtën e një shkopi të vogël me majë të holluar e të mprehtë, që përdoret për të shpuar ose që ngulet diku për të varur në të diçka, për të mbyllur një vrimë etj. Kunj druri (hekuri). Kunj për të mbjellë fidanë. Ngul kunjin. Vari pushkën në kunj. Vë kunjat në tokë. Nuk mban kunji. (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Masa për këpuca -

Nakuel – Hekur për mbajtjen e këpucës gjatë gozhdimit

Vosek – Ngjitës për ngjitjen e perit

Zëmba – Hapëse e birave

3.1.5.10. ZEJET E VEJTJES SË PËHURAVE TË PAMBUKUT

Kushtet e vështira të jetës, por edhe të punës në trojet shqiptare por në veçanti në viset malore i ka specifikat e veta. Për shkak të specifikave të punës blegtoare ku njerëzit qëndronin kohë të gjatë jashtë shtëpisë dhe stanit, por edhe për shkak se bëhej jetë nomade, ishin faktorë që ndikonin që këta njerëz të dallonin edhe në veshje. Këto veshje përbëheshin kryesisht nga leshi i dhenve e që në një mënyrë ishte e lidhur me jetën blegtoare. (Bexheti, Xhaferi, & Ibrahim, 2008, f. 38). Sipas autorit “Ky element etnografik që është i përbërë vetëm nga leshi i bardhë i dhenve, me siguri edhe zanafillën e ka te barinjtë dhe tek shqiptarët tjerë, që merreshin më zejen e blegtorisë. Kësula e bardhë (plisi), prodhohej nëpër qytetet shqiptare. Kësula (plisat) e Prizrenit, Tetovës, Gjakovës etj., përveç rolit identifikues kombëtar, varësisht nga forma, ishte edhe shenjë përcaktuese krahinore nëpër trojet shqiptare. (Bexheti, Xhaferi, & Ibrahim, 2008, f. 39).

Edhe në Rahovec ishte e përhapur kjo veprimtari zejtare, por se kanë mbetur vetëm disa gra në moshë, të cilat këtë veprimtari e ushtrojnë vetëm për të mos e humbur zanatin. Kjo sepse në kohën e sotme veshjet janë moderne dhe të ardhura nga prodhuesit dhe markat më të njohura botërore.

Këto janë fjalët që përdoren në këtë zhargon profesional:

Munash – Mëndafsh - Fije të holla dhe të ndritshme që nxirren nga fshikëza e një lloj krimbi dhe që përdoren; zakonisht për pëlhura të holla e për endje të tjera. Mëndafsh natyror. Mëndafsh artificial fije të holla që nxirren nga celuloza dhe që përdoren për pëlhura etj. Mëndafsh i punuar (i papunuar). Krimbi i mëndafshit. Fije mëndafshi. Pëlhurë mëndafshi. Stof (fustan, shall) mëndafshi. Këmishë (shami) mëndafshi. Perde mëndafshi. Industria e mëndafshit. Vë mëndafsh rrit krimba mëndafshi me gjethe mani për të marrë fijet e fshikëzave të tyre. Tërheq mëndafsh hedh në ujë të nxehtë fshikëzat dhe u heq fijet duke formuar me to palëza (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Najlon – Syra – Lëndë sintetike që nxirret nga rrëshirat, prej së cilës bëhen fije shumë të qëndrueshme; pëlhurë e endur me fije prej kësaj lënde. Fije najloni. Këmishë (çorape, perde) najloni. Stof najloni. Thes (qeskë) najloni (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981).

Kalem – Përdorëse që është si shkop i vogël. Kalemi i argjendarit. Kalemi i penjve (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Shtiza – Copë prej teli të hollë e të fortë ose prej një lënde tjetër, e gjatë afër një pëllëmbë e më shumë, me majë jo të mprehtë nga njëra anë dhe me kokë e me një si grep nga ana tjetër, që përdoret për të thurur çorape, triko etj. (me dy ose me pesë të tilla). Shtiza të holla (të trasha). Shtiza druri (kocke). Shtiza për çorape (për triko). Një palë shtiza. Punoj me shtiza. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981).

Mlojsa – Copë pëlhure, mushamaje etj., me të cilën mbulojmë diçka që duam ta mbrojmë nga ndonjë dëmtim nga lagështia, nga pluhuri etj.; copë pëlhure, zakonisht e qëndisur, që shtrohet mbi tryezë a mbi një orendi tjetër. Mbulesë e hollë (e trashë). Mbulesë e bardhë. Mbulesë e pastër. Mbulesë mushamaje (pëlhure, plastmase). Mbulesa e tryezës. Mbulesa e djepit. Mbulesa e topit (e mitralozit). Mbulesa e shtretërve të ngrohtë. I hodhi (i vuri) një mbulesë (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M, 1981).

Shuli – Dru i drejtë e i gjatë, i pastruar nga degët, që përdoret për punë të ndryshme, hu i gjatë. Shul i fortë (i gjatë). Shul mullari strumbullar. Shul tende. Shut gardhi (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981).

3.1.5.11. VERËTARIA

Verërat janë njëra nga veprimtaritë e cila në komunën e Rahovecit ka një interesim dhe zhvillim aq të madh, sa që në qytetin e Rahovecit, radhë mund të gjen ndonjë shtëpi e cila nuk merret me kultivim të rrushit. Ky kultivim i ka dy kategori të saja, në njërën anë rrushi i tryezës i cili plasohet në treg si ushqim dhe në anën tjetër kemi rrushin si lëndë e parë për prodhimin e rakisë dhe verërave të ndryshme.

Më datën 19 shtator 2017, gazeta e përditshme elektronike në Kosovë “Gazeta Express”, ka publikuar një artikull me titull “Prodhimtaria e rrushit dhe e verës sektor strategjik i Kosovës” (Express, 19.09.2017). Sipas këtij artikulli, 25 kompani prodhuese vazhdojnë traditën mijëvjeçare të prodhimit të verës. Për këtë sektor aty theksohet se “Ky sektor i prodhimit të rrushit dhe përpunimit të këtij produkti ishte shumë i zhvilluar deri në vitet e 90-ta. Deri në periudhën e paraluftës, sipërfaqet e kultivuara me vreshta kanë qenë shumë më të mëdha. Në vitin 1988 sipërfaqja me vreshta në Kosovë ka qenë rreth 9,000 ha, ndërsa sot në Kosovë kultivohen 3,117 ha, prej të cilave 769 ha janë me rrush tryeze dhe 2,348 ha me rrush për verë (Express, 19.09.2017).

4. KAPITULLI II

4.1. GJUHA SHQIPE

Është thënë edhe më herët, se gjuha është elementi themelor i komunikimit të qenieve njerëzore në mes vete. Pa gjuhë, as jeta nuk do të mund të imagjinohej. Prandaj, me zhvillimin historik të njerëzimit, edhe gjuha është përsosur deri në kohën tonë bashkëkohore.

Kur flasim për gjuhën shqipe, atëherë padyshim duhet të themi se ajo zë një vend qendror në gjuhët e Gadishullit Ballkanik. Ajo është pjesë e gjuhëve indoevropiane dhe është njëra ndër gjuhët më të vjetra të kontinentit të Evropës. Karakteri indoevropian i gjuhës shqipe, siç

thotë autorja Kume, “shfaqet në të gjitha nënsistemet e saj, duke ruajtur mjaft elemente të qenësishme të trashëgimisë indoevropiane (Kume, 2011, f. 8)”. Ndërsa për përcaktimin e vendit të gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve indoevropiane, G. Meyer është mbështetur në disa tipare që janë më të qëndrueshme, siç është sistemi fonetik dhe në strukturën morfologjike (Kume, 2011, f. 8).

Në lidhje me lashtësinë e gjuhëve të Gadishullit Ballkanik, gjuhëtari i slloven Kopitar, në vitin 1929, duke u bazuar në nyjat e prapavendosura në gjuhën shqipe, rumune dhe bullgare, erdhi në përfundim se këto tre gjuhë janë dominuese të Ballkanit, prej së cilës njëra është autoktone, ndërsa dy të tjerat kanë ardhur nga lindja dhe perëndimi (Demiraj, Gjuhësi Ballkanike, 1994, f. 9). Ky është një fakt shumë i rëndësishëm që tregon se gjuha shqipe është ndër gjuhët e para të këtij Gadishulli. Ndërsa, në lidhje me përkatësinë e gjuhës shqipe, gjuhëtarja shqiptare Kazazi shkruan se “prej më shumë se një shekulli është vërtetuar përfundimisht përkatësia e gjuhës shqipe, si dhe paraardhëses së saj ilirishtes, në grupin e gjuhëve indoevropiane” (Kazazi, 2014, f. 10). Me këtë ajo konstaton lidhshmërinë historike dhe gjuhësore të shqiptarëve me ilirët. Për ta vërtetuar këtë lidhshmëri, ajo ka përdorur një metodë mjaft të mirë krahasuese historike dhe arkeologjike.

Historikisht, Gadishulli Ballkanik ka qenë i populluar shumë herët. Siç kemi cekur edhe më parë, në këtë popullim ka ndikuar pozita gjeografike si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël. Autori i shquar Demiraj në lidhje me pozitën gjeografike dhe gjuhën shkruan se “ky pozicion i ka dhënë shkas edhe për dyndje të herëpashershme të popujve dhe fiseve të ndryshme që, edhe kur janë asimiluar nga banorët më të hershëm prapë kanë lënë herë më shumë e herë më pak gjurmë në gjuhët e folura në këtë Gadishull” (Demiraj, Gjuhësi Ballkanike, 1994, f. 27).

Përkundër këtyre dyndjeve të herëpashershme të popujve dhe fiseve të ndryshme, gjuha shqipe si njëra ndër gjuhët më të vjetra indoevropiane, është njëra nga gjuhët e cila i ka

qëndruar rrebesheve të kohës. Me gjithë trysnitë e forta dhe të gjata të sllavishtes, turqishtes, greqishtes dhe latinishtes, ajo ka ruajtur tiparet e saj thelbësore. Natyrisht, këto trysni të huaja kanë lënë gjurmë, kryesisht në fjalorin e saj (Kazazi, 2014, f. 10).

Kur flasim rreth çështjes së formimit të gjuhës shqipe, duhet të theksojmë se, siç dihet ka probleme e problematika dhe vështirësi edhe sot. Këto probleme lidhen me mungesën e dokumentimit të hershëm të gjuhës shqipe, për shkak të mosnjohjes së gjuhës mëmë (ilirishtes), nga e cila ajo ka rrjedhur dhe është zhvilluar pa ndërmjetësim. Pra, është shumë vështirë t'i përgjigjemi pyetjes se nga cila kohë gjuha e kësaj popullsie autoktone mori përfundimisht tiparet thelbësore, që shënuan kalimin nga gjuha “nënë” në një gjuhë cilësisht të re? Shkenca gjuhësore, sot referencën kryesore e ka shkencën e arkeologjisë dhe historisë. Këto dy shkenca e kanë dhënë ndihmesën e vetë, sepse në këtë mënyrë është përcaktuar vazhdimësia e pandërprerë e kulturës në brigjet lindore të Adriatikut dhe është përcaktuar trualli ku është zhvilluar gjuha shqipe (Kazazi, 2014, f. 10).

4.2. GJUHA LETRARE SHQIPE DHE GJUHA POPULLORE

Kur flasim për gjuhën shqipe, sikur në gjuhët tjera edhe gjuha shqipe ka një zhvillim të evolucionit historik. Siç thotë Demiraj “evolucioni historik i sistemit të një gjuhe në përgjithësi dhe i strukturës së saj gramatikore, në veçanti, nuk është një proces i zhvilluar në mënyrë kaotike”. Ky studim historik sipas tij, duhet të synojë të bëj zbulimin e përgjithshëm të drejtimit të evolucionit si dhe ti gjej faktorët kryesorë që i dhanë shkas atij (Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, 1988, f. 27). Gjatë gjithë këtij evolucionit, gjuha shqipe është përsosur deri më sot në këtë gjuhë të unisuar letrare. Kur flasim për studimet etnolinguistike në gjuhën shqipe, sidomos për dallimet ndërmjet gjuhës letrare dhe asaj

popullore, në krahasim me vendet tjera, etnolinguistika si disiplinë gjuhësore në hapësirat shqiptare paraqitet mjaft vonë dhe atë në dekadën e fundit të shek.XX (Ibrahimi, Gjuhë dhe kulturë, 2016, f. 36).

Por, në të vërtetë shtrohet pyetja se a përdoret vetëm gjuha letrare në përditshmëri? Pa dyshim se jo. Sidomos në gjuhën shqipe aty ku flitet dialekti gegë, kemi një dallim të madh ndërmjet përdorimit të gjuhës letrare dhe gjuhës popullore. Derisa në përdorim formal, sidomos në të shkruar përdoret standardi, në raste të tjera nuk mund të thuhet se përdoret në nivel të kënaqshëm. Në Kosovë, përdorimi i gjuhës popullore shfaqet në dialektin gegë. Disa media dhe gazetarë në Kosovë edhe e kanë promovuar dialektin gegë si vlerë të shtuar duke transmetuar në këtë dialekt. Është fakt botërisht i ditur që televizioni “Rrokum” në krye me gazetarin Migjen Kelmendi e ka promovuar dhe përdorur dialektin Gegë gjatë transmetimit të këtij televizioni.

Përveç gjuhës së unisuar letrare, na paraqiten edhe zhargonet popullore, qoftë të përditshmërisë, por edhe të veprimtarive të ndryshme. Ndërsa fjala zhargon përkufizohet si “e folme e një shtrese të ngushtë shoqërore ose e një grupi njerëzish të një profesioni, e cila ka shumë fjalë e shprehje të veçanta, profesionale ose të huaja, të panjohura a të krijuara posaçërisht dhe nuk kuptohet nga shtresat e tjera shoqërore (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH, 1981, f. 2257).

Gjuha letrare është duke u përsosur në vazhdimësi por zhargonet nuk i ndihmojnë fare në këtë drejtim. Duhet një përpjekje më e madhe në këtë drejtim nga të gjitha nivelet sidomos në nivelin fillor dhe të mesëm të shkollimit t’i kujdeset një rëndësi më e madhe. Shkolla, mediat dhe institucionet në përgjithësi duhet t’i ndihmojnë procesit të përmirësimit të gjuhës së zhargonit nga gjuha letrare dhe jo të ndodh e kundërta.

Në lidhje me përvetësimin e gjuhës letrare shqipe, autori Ibrahimi në librin e tij shtron pyetjen se “a jemi të kënaqur me nivelin e përvetësimit të gjuhës letrare dhe kulturës

gjuhësore të nxënësit, studentët dhe në përgjithësi të popullatës shqiptare”? (Ibrahimi, Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike, 2012, f. 117).

Nga gjendja faktike dhe reale që mbretëron konstaton se “në shkollat, fakultetet dhe institucionet nuk mund të jemi të kënaqur dhe lëshimet duhet t’i kërkojmë si në sistemin tonë arsimor, ashtu edhe në kujdesin tonë ndaj gjuhës letrare (Ibrahimi, Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike, 2012, f. 117).

4.3. GJUHA E ZEJTARËVE

Gjuha e zejtarëve është pjesë e zhargonit të profesioneve, që ne e dhamë definicionin e saj sipas fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe. Zhargonet e profesioneve e kanë karakteristikën e tyre dhe kjo lidhet me përdorimin e termave në mënyrën shabllonike dhe pretencioze, gjë që ia vret veshin edhe dëgjuesit dhe në të njëjtën kohë nuk ka kreativitet dhe vlerësohet si negativ (Ibrahimi, Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike, 2012, f. 134).

Gjuha e zejtarëve është një gjuhë karakteristike sepse fjalët e përdorura në të shumtën e rasteve nuk kanë të bëjnë fare me gjuhën që e përdorin. Përdorin terma të gjuhëve të huaja në të shumtën e rasteve dhe janë të pakuptueshëm për dëgjuesin e thjeshtë, por edhe për njerëz të profesionit të njëjtë në disa raste.

Përveç rastit që në Kosovë serbishtja ka ndikuar në masë të madhe në krijimin e fjalëve të shumta në gjuhën e zejtarëve, jeta e gjatë në diasporë e shumë njerëzve që sot punojnë në trojet shqipfolëse ka ndikuar që të sjellin fjalë nga vendet ku kanë punuar.

Për dallim prej profesioneve të tjera, të cilët janë profesione shkencore sikur në lëmin e mjekësisë, drejtësisë apo ekonomisë, ku zhargoni i fjalëve formësohet në bazë të literaturës dhe të njëjtat fjalë përdoren edhe nga kolegët e tyre në shtetet tjera, në gjuhën e zejtarëve fjalët krijohen spontanisht me përdorim të përditshëm.

Zejtaria sot është një lëmi mjaft e përhapur, prandaj edhe termat e zhargonit të tyre kanë ndikuar në masë të madhe në fjalorin e gjuhës popullore. Kjo shihet në një bisedë të thjeshtë, joformale me njerëz të cilët mund të tregojnë se si kanë shkuar tek një mjeshtër dhe kanë riparuar ndonjë veturë apo diçka rreth shtëpisë së tyre.

E gjithë çka duhet të bëhet është që të vetëdijesohen edhe ata në përdorimin e termave të bazohen në gjuhën shqipe sa më shumë. Por, natyrisht se për këtë duhen kohë, sepse gjuha e zejtarëve aq shumë është e ndikuar nga fjalët e huaja sa që do të nevojitet kohë e gjatë për ta përmirësuar gjendjen.

4.4. GJUHA E ZEJTARËVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Sikur në vendet tjera shqipfolëse, edhe në komunën e Rahovecit, zejtarët e kanë zhargonin e tyre të folurit. Ky zhargon në masë të madhe përdor fjalë të huazuara nga gjuhët e huaja, të cilët kanë hyrë në fjalorin e tyre të përditshëm të tyre dhe në këtë formë edhe në gjuhën popullore të kësaj komune.

Ndikimi i fjalëve tek zejtarët e komunës së Rahovecit ka të bëjë me atë se në cilën fazë është zhvilluar ajo veprimtari. Derisa tek xhamaprerësit për shkak të zhvillimit të hershëm të kësaj veprimtarie ka ndikuar gjuha turke, tek të tjerët shihet një ndikim më i madh i fjalëve nga gjuha sllave apo gjuhët tjera të perëndimit. Me zhvillimin e madh të teknologjisë informative, sistemet elektrike të veturave janë përsosur në atë masë sa që sot, veturat e reja përmbajnë kompjuterët më të avancuar në brendinë e tyre. Kjo ka bërë që edhe veprimtaria e elektrikistëve të veturave të përsoset bashkë me ta. Ndërsa gjuha dominuese e kësaj kategorie zakonisht është gjuha angleze. Krejt kjo sipas tyre për shkak se gjuhët programuese në teknologjinë informative janë në gjuhën angleze. P.sh. Gjatë kësaj veprimtarie zejtarët në ri programim thonë se e kanë ndërruar “fajlin”. Në të ardhmen kemi tendenca të rritjes së fjalëve dominuese në gjuhën angleze. Sepse anglishtja padyshim se është gjuha kryesore e

planetit tonë. Sipas autorit Ibrahim, “ndonëse kemi rënie të përdorimit të anglishtes në internet në krahasim me gjuhët tjera, ajo mbetet gjuha që zë hapësirën më të madhe në internet” (Ibrahimi, Gjuhë dhe kulturë, 2016, f. 23).

Ndonëse komuna e Rahovecit njihet si vend bujqësor, ku zejtaria ka predispozita të mëdha të rritjes në të ardhmen, prej zejtarëve më të vjetër edhe më të rinjtë kanë trashëguar terminologjinë e zhargonit të tyre me fjalë të shumta të huazuara, të cilat nuk kanë fare lidhje me gjuhën shqipe. Kjo vërehet edhe tek mjetet e punës, ndonëse për shumicën e mjeteve ne kemi fjalë të gjuhës shqipe, ende mbretëron përdorimi i fjalëve të huazuara, p.sh. për aparatën e saldimit e përdorin termin “Shvajc aparat”.

5. KAPITULLI IV

5.1. ANALIZA E TË DHËNAVE

Analiza e të dhënave është njëra ndër fazat më të rëndësishme të këtij punimi. Kjo sepse metoda e analizës nënkupton zbërthimin e elementeve krijuese por edhe të mendimeve. Varësisht nga shkenca, edhe analizat e të dhënave realizohen në mënyra të ndryshme (Jakupi, 2005, f. 24). Në këtë punim, analiza e të dhënave realizohet duke u bazuar në rezultatet e anketave dhe me përfundimet nga anketat.

5.1.1. REZULTATET NGA ANKETAT

Nga anketat e realizuara me zejtarët e ndryshëm të cilët veç janë dhënë në pjesën e zejeve të ndryshme janë rritur këto rezultate:


Me automekanikët në pjesën e motorit dhe të çelësave të cilat i përdorin, sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e automekanikëve kemi këto rezultate:

Në pjesën e motorit dhe pjesëve përcjellëse të veturave kemi:

- 50 (pesëdhjetë) fjalë me origjinë sllave;
- 26 (njëzet e gjashtë) fjalë me origjinë shqipe;
- 5 (pesë) fjalë me origjinë gjermane dhe
- 2 (dy) fjalë me origjinë angleze.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 2: Tabela e fjalëve të përdorura në pjesët motorike dhe përcjellëse të veturave nga zejtarët e komunës së Rahovecit.




Ndërsa në pjesën e çelësave të automekanikëve kemi këtë rezultat:

- 22 (njëzet e dy) fjalë me origjinë sllave;
- 5 (pesë) fjalë me origjinë shqipe dhe

- 1 (një) fjalë me origjinë gjermane.

Gjithashtu me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:


Tabela 3: Tabela e fjalëve të përdorura në pjesët e çelësave nga zejtarët e komunës së Rahovecit.



Siç shihet edhe nga diagramet e mësipërm, tek automekanikët në zhargonin profesional, dominon përdorimi i fjalëve me origjinë nga gjuhët sllave si në pjesën e motorit dhe të pjesëve përcjellëse, por edhe në pjesën e veglave apo çelësave të tyre.

Marrë së bashku pjesët dhe çelësat në diagram mund të përmbledhim kështu:

Tabela 4: Pjesët e veturave dhe të çelësave apo veglave të përmbledhura në një diagram në zejtarinë e automekanikëve.




Me zejtarët e karrocerisë sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e zejtarëve të karrocerisë, kemi këto rezultate:

- 11 (njëmbëdhjetë) fjalë me origjinë shqipe;
- 9 (nëntë) fjalë me origjinë sllave;
- 2 (dy) fjalë me origjinë gjermane dhe
- 1 (një) fjalë me origjinë angleze.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 5: Fjalët e përdorura nga zejtarët e karrocerisë




Me zejtarët ujësjellës sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e zejtarëve të ujësjellësit, kemi këto rezultate:

- 26 (njëzet e gjashtë) fjalë me origjinë shqipe;
- 16 (gjashtëmbëdhjetë) fjalë me origjinë sllave;
- 5 (pesë) fjalë me origjinë gjermane dhe
- 3 (tre) fjalë me origjinë angleze.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 6 Fjalët e përdorura nga ujësjellësit




Me argjendarët sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e zejtarëve të argjendarëve, kemi këto rezultate:

- 20 (njëzet) fjalë me origjinë shqipe;
- 9 (nëntë) fjalë me origjinë sllave;
- 2 (dy) fjalë me origjinë gjermane;
- 2 (dy) fjalë me origjinë angleze dhe
- 2 (dy) fjalë me origjinë turke.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 7: Fjalët e përdorura nga argjendarët



Me zrukthëtarët sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e zejtarëve të zdrukthëtarëve, kemi këto rezultate:

- 7 (shtatë) fjalë me origjinë shqipe;
- 5 (pesë) fjalë me origjinë sllave;
- 1 (një) fjalë me origjinë gjermane dhe
- 3 (tre) fjalë me origjinë turke.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 8. Fjalët e përdurura nga zdrukthëtarët




Me xhamaprerësit sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin xhamaprerësit, kemi këto rezultate:

- 3 (tre) fjalë me origjinë shqipe;
- 2 (dy) fjalë me origjinë sllave;
- 3 (tre) fjalë me origjinë turke dhe
- 2 (dy) fjalë me origjinë angleze.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 9: Fjalët e përdorura nga xhamaprerësit




Me rrobaqepëset sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e zejtarëve të rrobaqepësisë, kemi këto rezultate:

- 9 (nëntë) fjalë me origjinë shqipe dhe
- 1 (një) fjalë me origjinë turke.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 10: Fjalët e përdorura nga rrobaqepëset



Me frizeret sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e frizereve, kemi këto rezultate:

- 10 (dhjetë) fjalë me origjinë shqipe;
- 4 (katër) fjalë me origjinë sllave dhe
- 1 (një) fjalë me origjinë frënge.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 11: Fjalët e përdorura nga frizeret




Me këpucëtarët sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e këpucëtarët, kemi këto rezultate:

- 12 (dymbëdhjetë) fjalë me origjinë shqipe dhe
- 4 (katër) fjalë me origjinë sllave.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 12: Fjalët e përdorura nga këpucëtarët




Me zejet e vejtjes së pëlhurave dhe pambukut sipas fjalëve që i kemi prezantuar në titullin e këpucëtarët, kemi këto rezultate:

- 5 (pesë) fjalë me origjinë shqipe dhe
- 1 (një) fjalë me origjinë turke.

Me anë të diagramit kjo mund të ilustruhet kështu:

Tabela 13: Fjalët e përdorura nga këpucëtarët




5.1.2. PËRFUNDIMET NGA ANKETAT

Rezultatet e arritura në këto lloje të profesioneve zejtare na kanë dhënë edhe përfundime të ndryshme. Konteksti i punës, zhvillimit të saj etimologjik dhe përmirësimi i përditshëm i saj në vijimësi, ka sjellë edhe deri te rezultatet e ndryshme.

Nëse i analizojmë të gjitha këto profesione në një diagram, do të kemi këtë rezultat:

Tabela 14: Të dhënat e të gjitha grupeve



6. KAPITULLI V

6.1. PËRFUNIMET DHE REKOMANDIMET

Qysh në fillim është thënë që gjuha është mjeti më themelor i komunikimit ndërmjet njerëzve. Por, komunikimi ndërmjet zejtarëve është i një kategorie të veçantë. Ky lloj komunikimi në gjuhësi quhet zhargon. Zhargonet zakonisht kanë edhe të metat e tyre dhe janë të pakuptueshme për njerëzit e rëndomtë, sepse ky komunikim përbëhet nga fjalët dhe frazat që njerëzit e tjerë vështirë se do ta kuptojnë.

Me anketat dhe analizat që i kemi bërë, por edhe në hipotezat që në fillim i kemi ngritur, kemi arritur në përfundim se:

- Gjuha e zejtarëve është gjuhë profesionale,
- Çdo zeje i ka specifikat e veta gjuhësore,
- Gjuha e zejtarëve është e ndikuar nga vendet e ndryshme ku ajo i ka fillet e saj,
- Dita ditës fjalë të tilla gjejnë përdorim në komunikimin e përditshëm të shoqërisë.

Gjuha e zejtarëve është gjuhë profesionale sepse është gjuhë të cilën e ushtrojnë njerëzit e veprimtarisë së caktuar. Kemi thënë edhe në fillim se kemi veprimtari të caktuara të cilat janë mjaft të zhvilluara, sepse burojnë drejtpërdrejt nga shkenca e tillë, si p.sh. mjekësia, drejtësia, ekonomia etj., ndërsa gjuha e zejtarëve të një zanati të caktuar është zhargon i zejtarëve, apo siç i thonë ata “gjuhë e mjeshtërve”.

Çdo zeje i ka specifikat e veta sepse dallon konteksti i fillesës dhe i zhvillimit të atij zanati.

Specifikat e tilla kanë të bëjnë me punën që e kryejnë dhe me vendin e prodhimit të sendeve dhe pjesëve të asaj zëjtarie.

Gjuha e zejtarëve është e ndikuar nga vendet e ndryshme ku ajo i ka fillesat e saj sepse derisa frizeret zhvillimin e tyre të hovshëm e kanë përjetuar në fillimin e këtij shekulli,

kur Kosova është çliruar dhe pavarësuar, disa të tjera fillesat i kanë që nga koha e sistemit të RSFJ-së, ku gjuhë zyrtare e atij shteti ishte gjuha serbo-kroate.

Dita ditës fjalë të tilla gjejnë përdorim në komunikimin e përditshëm të shoqërisë sepse përdorimi i tillë i shpeshtë në këtë komunikim ka sjellë situatën e përdorimit të këtyre fjalëve edhe në komunikimin e përditshëm të shoqërisë.

Edhe pse këta zejtarë e kanë më të lehtë komunikimin e tillë, mendoj se ata duhet të fokusohen sa më shumë në gjuhën shqipe. Kjo nuk është e lehtë për tu arritur, por duhet të organizohen sa më shumë trajnime profesionale.

Kategoria e gjuhës dhe kulturës ka një rëndësi të veçantë për secilin popull, prandaj gjuha dhe kultura duhet të ruhet sa më shumë. Por duhet të kemi parasysh që teknika dhe teknologjia është duke u zhvilluar me një shpejtësi të madhe, sa që gjuhën shpesh e gjen në një situatë kur ndonjë fjalë duhet ta plotësoj në fjalorin e saj. Nuk duhet të jemi kundër plotësimit të gjuhës, por duhet të kihet kujdes se cilën fjalë do ta përfshijmë në fjalorin e gjuhës shqipe.

Si rezultat i ndryshimeve të mëdha tekniko-teknologjike, disa lloje të veprimtare zejtare janë në shuarje e sipër, kurse disa lloje të veprimtarive të kësaj natyre janë në zhvillim aq të madh, sa që edhe një kohë të gjatë do të jenë ndër profesionet më të ushtruara. Kjo do të ndikojë që edhe gjuha e përditshme të ndikohet nga këto fjalë, sepse p.sh. veprimtaritë që kanë të bëjnë me veturat, janë mjaft tërheqëse për pjesën më të madhe të njerëzve.

6.2. REFERENCAT

- Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, S., Dhirmo, A., Hysa, E., Lafe, E., & Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Bajrami, A. (2002). *E Drejta e Kosovës në Tranzicion (E Drejta Kushtetuese – Libri II)*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Bexheti, V., Xhaferi, H., & Ibrahimimi, M. (2008). *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*. Tetovë: UEJL.
- Bokshi, B. (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e arteve të Kosovës.
- Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansau, S., Përnaska, R., Prifti, S., & Totoni, M. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Dameska, L. (2010). *Ekonomia për vitin e katërt (Lëndë e rregullt dhe zgjedhore)*. Shkup: Ministria për Arsimit dhe Shkencë të Republikës së Maqedonisë.
- Demiraj, S. (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- Demiraj, S. (1994). *Gjuhësi Ballkanike*. Shkup: Fokus.
- Demiraj, S. (2003). *Gjuha shqipe - Probleme dhe disa figura të shquara të saj*. Tiranë: Globus R.
- Dodi, A. (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Doli - Kryeziu, S. (2013). *Shtrirja e shqipes standarde në Gjakovë (Punim në gradën shkencore "Doktor" në gjuhësi)*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.
- Dulaj, F. (2016). *E folmja e Rahovecit me rrethinë*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Express, G. (19.09.2017). Prodhimtaria e rrushit dhe e verës sektor strategjik i Kosovës. *Gazeta Express*.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A - M*. (1981). Prishtinë: Rilindja.
- Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N - ZH*. (1981). Prishtinë: Rilindja.
- Frashëri, K. (2008). *Historia e qytetërimit shqiptar (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Gaxheri, A. (30.11.2016). *Familja Grezda, 100 vjet traditë si xhamaprerës*. Prishtinë: Klan Kosova.
- Gjinari, J., & Shkurtaj, G. (2003). *Dialektologji*. Tiranë: Perlat Voshtina.
- Gjocaj, Z. (2001). *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Gjocaj, Z. (2009). *Trajtesa frazeo-stilistike të shqipes*. Prishtinë: Era.
- Holmes, J. (2015). *Hyrje në sociolinguistikë*. Tiranë: Pegi.
- Ibrahimimi, M. (2012). *Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike*. Shkup: Interlingua.
- Ibrahimimi, M. (2016). *Gjuhë dhe kulturë*. Shkup: Interlingua.

- Ismaili, H., & Sejdiu, F. (2005). *Historia e shtetit dhe e së drejtës I*. Prishtinë: Koha.
- Ismaili, O. (2004). *Fillet e së Drejtës*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Ismajli, R. (1987). *Artikuj mbi gjuhën shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- Jakupi, A. (2005). *Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Kadriu, Z. (2007). *Norma e gjuhës standarde shqipe*. Tetovë: SH. B. Blana.
- Kazazi, L. (2014). *Përkthime dhe ndikime të italishtes me shqipen (mbi të dhënat e të folmes së qytetit të Shkodrës). Punim i gradës shkencore "Doktor" në gjuhësi*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.
- Klosi, D. (2014). *Çështje të variacionit gjuhësor në mjedisin universitar të qytetit të Vlorës. Punim në gradën shkencore "Doktor" në gjuhësi*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.
- Kosovës, A. e. (2017). *Vlerësim - Popullsia e Kosovës 2016*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- Kryeministrit, Z. e. (2017). *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Republika e Kosovës.
- Kume, J. (2011). *Elementet greke në gjuhën shqipe dhe statusi i tyre në shqipen standarde. Punim në gradën shkencore "Doktor" në gjuhësi*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.
- Ligji Nr. 70/2016 për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë. (2016, 06 30). Tiranë, Republika e Shqipërisë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr.2004/44 për Zejtari. (2006, 11 01). 6/01. Prishtinë, Republika e Kosovës: Gazeta e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.
- Lloshi, X. (2015). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë: Albas.
- Lokal, M. e. (2017). *Profili i komunave të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Republika e Kosovës.
- Mulaku, L., & Kelmendi, A. (1984). *Gramatika e gjuhës shqipe (fonetika dhe morfologjia)*. Prishtinë.
- Musliaj, A. (4 oct 2010). *Shqiptarët ishin mjeshtër të zotë të zejtarisë dhe argjendarisë*. Prishtinë: Bota Sot.
- OICA. (2019). *World Motor Vehicle Production: World Ranking of Manufacturers, Year 2017*. OICA.
- Omari, L., & Luarasi, A. (2001). *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*. Tiranë: Luarasi.
- Osmani, J. (2003). *Vendbanimet e Kosovës. Libri 2. Rahoveci*. Prishtinë.
- Paqarizi, R. (2011). *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*. Prishtinë: Pen Qendra e Kosovës.
- Paqarizi, R. (2012). *Fjalor i termave të psikolinguistikës*. Prishtinë: Pen Qendra e Kosovës.
- (2013). *Regjitrimi i Popullsisë Ekonomike Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- Riza, S. (1994). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë.

- Rugova, B., & Sejdiu - Rugova, L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat.
- Shkurta, G. (2001). *Onomastikë dhe etnolinguistikë*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Shkurta, G. (2003). *Sociolinguistika*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Shukriu, E. (2008). Parahistoria dhe historia antike e Kosovës. Thesis Kosova. *Thesis Kosova*, 5-28.
- Srebrenov, D., Senesov, P., & Zashov, G. (2012). *Automjetet dhe Mekanizmat*. Shkup: Graficki centar doel.
- Telegrafi. (09.02.2019). Në vitin 2018, kosovarët shpenzuan mbi 183 milionë për blerje të veturave. *Telegrafi.com*, 1.
- Topalli, K. (1998). *Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*. Tiranë: Toena.
- Topalli, K. (2009). *Sistemi rasor i emrave të shqipes*. Tiranë: Plejad.
- Vajs, A., & Kandi, L. (1976). *Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.
- Zakić, M., & Zindović, I. (2010). *Metodologija Naučno-Istraživačkog Rada*. Beograd: Birografika.
- ЗАКОН ЗА ЗАНАЕТЧИСТВО (Објавено во Сл. Весник на РМ, бр.215 од 07.12.2015 година). (2015, 07 12). Shkup: Објавено во Сл. Весник на РМ, бр.215 од 07.12.2015 година.

Vërtetoj se unë, Laureta Shehu Hamza, jam autorja origjinale e këtij punimi.